



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.04.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të datave 14, 15, 16, 21 shkurt dhe 7, 8, 15 dhe 16 mars 2022
- Seancë dëgjimore me Agjencinë për Media dhe Informim.

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Teuta Ramaj, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

Mungon:

Flutura Açka.

Të ftuar:

Endri Fuga - drejtori i Përgjithshëm i AMI-së

Elira Kokona - drejtore e Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë dhe zëvendëssekretare e Përgjithshme e Këshillit të Ministrave.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi -Mirdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 14, 15,16 dhe 21 shkurt dhe të datave 7, 8, 15 dhe 16 mars të këtij viti, si edhe seancë dëgjimore me Agjencinë për Median dhe Informim. Të ftuar kemi zotin Endri Fuga, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Median dhe Informim dhe zonjën e Elira Kokona, drejtore e Përputhshmërisë dhe zëvendëssekretare e përgjithshme e Këshillit të Ministrave.

Mirë se erdhët!

Së pari, do të miratojmë procesverbalet. Kanë ardhur me vonesë për arsye objektive, sepse redaktorët janë marrë me komisionin hetimor për inceneratorët dhe kanë pasur një volum pune të jashtëzakonshëm. Kush është dakord me procesverbalet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohen.

Atëherë, fillojmë seancën dëgjimore me Agjencinë për Mediat dhe Informimin. Është një seancë dëgjimore e rëndësishme, sepse ne kërkojmë që në një komunikim të drejtpërdrejtë, të informohemi lidhur me qëllimet e krijimit të agjencisë, funksionimin, strukturën dhe natyrisht mënyrën si është duke u implementuar vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave. Promotore e kësaj seance dëgjimore ka qenë opozita, sepse është institucioni i dyshimit; këtë ne duhet ta mirëkuptojmë. Ka pasur një sërë pyetjesh lidhur me Agjencinë. Shpesh ka pasur akuza të natyrës politike, sikur agjencia do të cenonte të drejtën për informim, mund të krijonte vakum dhe zbrazëti në hapësirën në mes publikut dhe institucioneve, ose mund të krijonte terr informativ për aspekte të ndryshme të qeverisjes dhe një sërë problematikash të tjera.

Unë besoj se do të jetë një mbledhje produktive. Së pari, do të dëgjojmë drejtorin për një shpjegim për ato që thashë në fillim dhe pastaj kolegët deputetë do të kenë pyetje. Është e drejta e komisionit që ndofta më vonë, në një situatë tjetër, pas një kohe dhe brenda një logjike perceptimi, ne të bëjmë edhe një seancë tjetër.

Zoti Fuga, fjala për ju.

Endri Fuga- Të nderur deputetë, ju falënderoj për këtë ftesë dhe këtë mundësi për të shpjeguar misionin dhe funksionin e Agjencisë për Media dhe Informim!

Për qeverinë shqiptare komunikimi me publikun dhe median, në mënyrë sa më të hapur dhe transparente, mbetet një nga prioritet kryesore. Pikërisht prandaj në janar të këtij viti pak më shumë se tre muaj më parë filloi të funksionojë kjo agjenci, duke marrë për bazë modelin gjerman të Agjencisë Federale për Shtypin dhe Informimin. Me synimi për të qenë më profesional për t'iu

përgjigjur më shpejt dhe më saktë përfaqësuesve të medias, si edhe për të pasur një koordinim më të mirë për të gjitha çështjet që nuk prekin vetëm një institucion, por prekin nivele të ndryshme të qeverisë. Agjencia ka tri objektiva kryesore: së pari të informojë publikun për punën e qeverisë përmes të gjitha mjeteve të komunikimit dhe kanale mediatike; së dyti, të informojë medien përmes raporteve dhe kontakteve të vazhdueshme, por edhe duke zhvilluar konferenca për shtyp dhe evente të tjera në përmbushje të këtij funksioni; së treti, të informojë qeverinë dhe institucionet e varësisë për çështje publike debate, lajme ose çdo problematikë ose shqetësim tjetër që ngrihet nga media ose qytetarët. Struktura e Agjencisë përmban Drejtorinë e Informimit të Qytetarëve, me mision informimin e vazhdueshëm të qytetarëve për politikën nismat vendimet ose aktivitetet e shoqërisë. Kjo bëhet përmes llogarive në rrjetet sociale, faqeve të Kryeministrit ose ministrive institucioneve të varësisë nëpërmjet fushatave të ndryshme ndërgjegjëse ose mjeteve të tjera sipas rastit; përmban Drejtorinë e Informimit të Medies që i përgjigjet kërkesave të gazetarëve dhe përfaqësuesve të medias vendase ose të huaj, duke dhënë informacionin e kërkuar sa herë qeveria shqiptare ka një qëndrim të caktuar për çështjen për të cilën kërkohet informacion; Drejtorinë e Informimit të Institucioneve Hulumtimit dhe Përmbajtjes, e cila përkujdeset që çdo institucion të jetë në dijeni të çështjeve kryesore të ditës debateve publike problematikave të ndryshme, lajmeve në vendin tonë në rajon ose botë si dhe përgatitjen e përmbajtjes së materialeve të ndryshme të nevojshme për komunikimin publik të qeverisë; Drejtorinë e Koordinimit të Ministrive dhe Agjencive me një numër prej 15 punonjësish ku çdo ministri përfaqësohet përmes zëdhënësit të vet, të cilët për hir të së vërtetës vazhdojnë dhe punojnë pranë institucioneve përkatëse. Qëllimi i kësaj drejtorie është të koordinojë punën agjendën publike të Këshillit të Ministrave me fokus të veçantë tema që prekin disa ministri ose institucione varësie; Drejtorinë e Produksionit dhe Eventeve që kujdeset për organizmin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve publike të Kryeministrit dhe ministrave, por edhe për prodhimin e materialeve të komunikimit kryesisht në rrjetet sociale, së fundi spektrorin e financave dhe shërbimeve mbështetëse që është përgjegjëse për miradministrimin e burimeve financiare njerëzore dhe asetëve të Agjencisë.

Unë nuk dua të zgjatem më tej dhe të marr më shumë kohë, por po jua lë kohën juve për të sqaruar çdo lloj pyetje që ju mund të keni për temën për të cilën jam thërritur në këtë dëgjësë.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit për pasqyrën paraprake të qëllimeve dhe objektivave të krijimit agjencisë, mënyrën si funksionon dhe, natyrisht, edhe një shpjegim për strukturën.

Hapim seancën e pyetjeve të cilat do t'ju lutesha të ishin teknike. Ne jemi palë politike dhe anojmë nga politika, por unë do të kërkoja nga ju që në përgjigje të jeni teknikë, që të përputheni për çështjen për të cilën jeni thirrur.

Kush e do fjalën? Zonja Zhupa.

Ina Zhupa -Faleminderit!

Para se ta nis fjalën, dua një mirëkuptim nga anëtarët e komisionit që do të procedoj në mënyrën e komisioneve të tjera, duke pasur bashkëbisedim me zotin Fuga me pyetje dhe përgjigje dhe jo me metodën që kemi përdorur si komision, që unë lexoj 30 pyetje dhe ju pastaj zgjidhni se cilës pyetje doni t'i ktheni përgjigje. Kështu që do të funksionojë me dy mikrofova. Unë ju drejtoj pyetjen, ju përgjigjet dhe kështu vazhdojmë në modelin e komisioneve të tjera.

Zoti Fuga, ju jeni ministri i propagandës së qeverisë, gjë të cilën e bazoj edhe në atë që është miratuar me VKM, pasi thotë që drejtori i Përgjithshëm ka status të njëjtë me atë të ministrit të Shtetit. Kështu që, de facto, ju jeni ministri i propagandës së qeverisë së Edi Ramës dhe si agjenci keni për detyrë ta përcillni sa më mirë propagandën e qeverisë “Rama”, atë që ata duhet të bëjnë më shumë sesa atë që ata bëjnë. Për këtë do t'ju pyes edhe më gjatë, sepse kjo është një agjenci që funksionon me fondet e taksapaguesve shqiptarë.

Nëse Edi Rama na ka thënë deri dje që ERTV-ja është kanali i tij personal dhe i mbulon vetë shpenzimet e atij kanali në faqen e *Facebook*-ut, ato kalojnë nga ky stad, ku për propagandën supozohej të kujdesej me paratë e veta, te një stad më i avancuar, ku për propagandën e tij kujdeset me paratë e taksapaguesve shqiptarë, si dhe krijon një agjenci të tërë, ku emëron një drejtor në nivel ministri dhe ka 61 punonjës, të paktën të deklaruar, për këtë gjë.

Unë i kam marrë një për një. Të gjitha për mua janë të rëndësishme. Kështu që do të filloj direkt me pyetjet, në mënyrë që të kemi mundësi që njëri-tjetrin dhe publikun ta sqarojmë më shumë për paratë që shkojnë në këtë ministri të propagandës.

Drejtori i Përgjithshëm, ju...

Po i nis çështjet sipas...

(Një deputete kërkon fjalën pa mikrofon.)

Ina Zhupa – ... asaj që i ka renditur.

Petro Koçi – Ja, një sekondë!

Ina Zhupa – Jo, nuk mund të merret fjala për procedurë, ndërkohë që unë flas!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Drejtori i Përgjithshëm emëron zëdhënësit e ministrive”, kjo sipas VKM-së. Pra, ju emëroni zëdhënësit e ministrive përkatëse dhe ata janë nën varësinë tuaj. Bie fjala, zëdhënësi i një ministri nuk është në varësi të ministrit, për të cilin është zëdhënësi, por është nën varësinë tuaj.

Tani, ju e keni shumë kollaj, sepse keni një qeveri monokolor, që me 71 mandate e keni kaluar 74, dhe i keni të gjithë në rresht për Ramën, prandaj nuk ankohet njeri nga ministrat se ia emëron dhe shkarkon ti zëdhënësin, se ia vendos ti se cilin do të ketë zëdhënësi. Pra, se varet nga ty, jo nga ministri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetja ime është: duke qenë se e keni marrë si agjenci këtë kompetencë apo jua kanë dhënë, sepse jua ka dhënë Edi Rama kompetencën e zëdhënësve, i bie që ju të emëroni dhe të komandoni edhe zëdhënësit e ministrave. Për shembull, kur kishit në vitin 2013-2017 zëdhënësin e Petrit Vasilit, zëdhënësin e Ylli Manjanit, të cilët i keni pasur ministra, apo nesër një ministër tjetër, jua komandoni ju me regji qendrore se çfarë duhet të thonë ministrat e qeverisë? Kjo është pyetja ime e parë për të vazhduar me të tjerat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi – Një sekondë, se fjalën e jap unë!

Tani, ne do të procedojmë siç duhet.

Ina Zhupa – Me pyetje-përgjigje.

Petro Koçi – Jo, ju do të bëni pyetjet tuaja, zoti Fuga dhe kolegët mund të mbajnë shënime, sepse nga pyetjet mund të nxiten, po themi, arsye për pyetje plus... Nuk mund ta bëjmë kështu si një debat me dy veta. Kjo është seancë dëgjimore, pra rregullisht bëhen disa pyetje... Sa pyetje keni ju?

Ina Zhupa – Zoti drejtues, unë kam disa pyetje, të cilat do t’ia drejtoj zotit Fuga.

Petro Koçi – Po, pra!

Ina Zhupa – Duke qenë se Agjencia është e re dhe nuk ka ardhur për një raportim vjetor apo për një raportim konstant...

Besion Ajazi - ...nuk ka ardhur për bashkëbisedim me ty, por ka ardhur për komisionin.

Ina Zhupa – Nuk do të bëj bashkëbisedim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...nuk kam dëshirë të bëj bashkëbisedim, ndryshe do ta kisha ftuar në një bashkëbisedim...

Besion Ajazi - Pyetjen shtrojeni siç e ka traditë parlamenti këtu e 30 vjet.

Ina Zhupa – Të lutem!

Komisionet parlamentare, mund të lexoni edhe më shumë mbi rregulloret, por mund të pyesni edhe ata në komisionet e tjera, i zhvillojnë seancat dëgjimore me pyetje-përgjigje, pyetje-përgjigje sa mbaron zotëria apo zonja që po bën pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk e kam problem që pyetjet t'i bëj të njëzeta, por nga përgjigjja e zotit Fuga, do të reflektoj edhe në pyetje të tjera, që ndoshta nuk janë të nevojshme për t'i bërë.

(Deputeti Ajazi flet pa mikrofon.)

Patjetër që ka ardhur për mua, sepse unë e kam kërkuar këtu. Ju e keni gjithë kohën, mund ta merrni dhe ta ftoni në kafe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – Tani të mos e zgjasim me këtë, por...

Ina Zhupa – Ju lutem, më lini të mbaroj...!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – ...mbaro me pyetjet. Sa ke 20, 50...?

Ina Zhupa – Zoti Koçi, ju jeni aty për të më dhënë fjalën mua.

Petro Koçi – Po pra, po...

Ina Zhupa – Tani që unë e kam fjalën...

Petro Koçi – ...ta kam dhënë fjalën, madje tani e ke marrë pa të ta dhënë unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Ai mbrohet vetë, përgjigjet vetë, bën edhe përgjigjet e Ramës. Kështu që nuk ka nevojë ta mbronin ju.

Petro Koçi – Edhe një herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Ai përgjigjet vetë. Lëreni të përgjigjet, zoti Koçi!

Petro Koçi – ...mos procedo në një mënyrë që i krijon mbrojtje zotit Fuga, por procedo në një mënyrë që ta sulmosh atë. Pra, bëj pyetjet...

Ina Zhupa – Tani, se si procedoj, e di unë...

Petro Koçi – Mirë pra!

Ina Zhupa – ...do të bëj njërën pyetje dhe do të marr përgjigjen, pastaj do të bëj pyetjen tjetër dhe do të marr përgjigjen nga zoti Fuga.

Petro Koçi – Tani, edhe një herë, komisioni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Edhe me forcën e kartonit e hedhim në votim ne, të ikë në shtëpi zoti Fuga dhe të mos e bëni fare ju.

Petro Koçi – Nuk ka votim këtu. Çfarë votimi flisni?

Ina Zhupa – Votoni për çfarë të doni, se e keni marrë këtë tani... e hedhim në votim. Hidhe në votim që të ikim ne në shtëpi!

Petro Koçi – Tani, a e kupton sa minuta po na merr kot?!

Ina Zhupa – Jo, po na i merrni ju, se unë bëra pyetjen dhe po pres përgjigjen!

Petro Koçi – Vazhdoni pra!

Ina Zhupa – Pastaj, do të bëj pyetjen tjetër dhe do të marr përgjigjen.

Besionj Ajazi - E përsëris, zoti Fuga nuk ka ardhur të bashkëbisedojë me ty.

Ina Zhupa – Zoti Ajazi, keni qenë pjesëtar i një komisioni hetimor bashkë me mua dhe mbledhja ka proceduar në të njëjtën mënyrë.

(Deputeti Ajazi flet pa mikrofon.)

Është vendimmarrje e deputetit se si i bën pyetjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – Edhe një herë, se...

Ina Zhupa – ...i bën një nga një apo të gjitha bashkë. Unë do t'i bëj një nga një. Ju do të keni durimin që në këtë seancë dëgjimore të qëndroni dhe t'i bëni një mijë e një pyetje zotit Fuga, në qoftë se keni, ose një mijë e një lavde. Zgjidheni ju se çfarë doni. Unë do t'i bëj pyetjet.

Petro Koçi – Tani, edhe koha ka racionalitetin e vet, se nuk do ta bëjmë me një mijë e dy pyetje...

Ina Zhupa – Nuk ka asnjë kufizim në Rregulloren e Kuvendit se sa pyetje do t'i drejtoj unë drejtorit të Agjencisë, ministrit të propagandës së qeverisë “Rama”!

Ju lutem shumë, lëreni të mbarojë, se keni 10 minuta që po na harxhoni kohë kot!

Petro Koçi – Edhe një herë, ne funksionojmë kështu, sepse jemi së bashku. Apo jo?

Ina Zhupa – Ju keni forcën e kartonit, e thashë, mund të thoni që ne të ikim dhe e vazhdoni vetë ju. Madje, pyeteni sa mirë po punon qeveria.

Më lejoni, ju lutem shumë, të mbaroj pyetjet në emër të...

Petro Koçi – Të mos fillojmë me karton tani.

Ina Zhupa – ...në emër të Rregullores...

Petro Koçi – Deri tani ke karton të verdhë.

Vazhdo, bëj pyetjet ose, të paktën, bëj nja 10 pyetje meqenëse ke 20 të tilla.

Ina Zhupa – Mund të pyesni edhe zotërinjtë këshilltarë, asgjë nuk ma ndalon mua se si do t'i bëj pyetjet dhe sa kohë do të marr për to.

Mos na harxhoni kohë kot! Lejojeni të përgjigjet dhe të vazhdoj unë me pyetjet e tjera, të cilat janë më shumë të rëndësishme sesa kjo!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, absolutisht jo, sepse unë do të mbaroj pyetjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zotëri!

Petro Koçi – Atëherë, zonja Zhupa, konsumoni pyetjet, sepse po e zgjasim kot.

Ina Zhupa – Zoti Koçi...

Petro Koçi – Ne do të procedojmë siç procedohet në komisione. Pra, ju keni pyetjet tuaja... Në rast se nga përgjigjet e zotit Fuga, ju do të keni arsye për të bërë pyetje të tjera, pasi të kenë bërë pyetje kolegë të tjerë, unë do t'jua jap fjalën sërish.

Ina Zhupa – Jo, nuk funksionon kështu!

Petro Koçi – Atë nuk e di ti...

(Deputetes Zhupa i ndërpritet fjala.)

Edhe një herë, a ka mundësi të...?

Ina Zhupa – Zoti Koçi, mos më ndërprisni fjalën!

Petro Koçi – Nuk po ju ndërpres fjalën, por ndërhyrjen e parregullt.

Ina Zhupa – Zoti Koçi, unë kam pyetje dhe...

(Deputetja Zhupa e vazhdon fjalën pa mikrofon): ...dua të marr përgjigje. Nuk i marr unë përgjigjet e mia, pasi mbarojnë të gjithë kolegët. Kështu, i lini ju zotit Fuga të thotë çfarë të dojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – Edhe një herë, se...

Ina Zhupa – Pikërisht, atë po kërkoj, të ma japë...

Ju lutem, mos më mbyllni mikrofonin, zoti Koçi!

Petro Koçi – Edhe një herë, se po flas unë tani, formuloni pyetjet.

Ina Zhupa *(flet pa mikrofon)* - Po krijoni një sherr të panevojshëm...

Petro Koçi – Edhe një herë, e nisët mbledhjen duke thënë që këtu ligjin e bëni ju. Kështu thatë: “Do ta bëjmë siç them unë, do të bëj unë nga një pyetje dhe do të marr përgjigje. Do të bëj prapë pyetje.”.

Ina Zhupa – Jo, do ta bëjmë siç e bëjnë komisionet e tjera dhe siç është e lejueshme brenda Rregullores së Kuvendit!

Petro Koçi – Ne do të veprojmë siç veprojmë zakonisht.

Mos e acarot kot një mbledhje që nuk ka asnjë arsye për të qenë e tillë!

E acaruat!

Ina Zhupa – Acarohu sa të duash. Unë do të vazhdoj, sepse këtë të drejtë...

Petro Koçi – Vazhdo pra, këtë po të themi!

Ina Zhupa – ...sepse mandatin e deputetit nuk ma keni dhënë ju.

Petro Koçi – Atëherë, zoti Fuga, do të prisni sa të konsumojë të gjitha pyetjet zonja Zhupa.

Nuk do të jepni asnjë përgjigje veç e veç.

Ina Zhupa – E urdhëroni ju zotin Fuga? Interesante.

Petro Koçi – Sigurisht, se unë e menaxhoj mbledhjen.

(Deputeti Ajazi ndërhyr pa mikrofon.)

Mbledhjen e drejtoj unë. Kur ta drejtosh ti, bëje si të duash!

Ina Zhupa – Faleminderit!

Petro Koçi – Po edhe ai që vjen, nuk është në hetuesi këtu që të përgjigjet sa herë të duam ne!

Ina Zhupa – Si në çdo komision tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Fuga, jeni i lirë të mos përgjigjeni, në qoftë se nuk keni përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë do të pres gjithë kohën përgjigje nga ju dhe në qoftë se ju nuk do të keni përgjigje apo do të urdhëroheni nga drejtues të përkohshëm të këtij komisioni, për shkak të një fatkeqësie shëndetësore të asaj që duhej të drejtonte këtë komision, ju jeni i lirë ta bëni.

Petro Koçi – Atëherë, do të vazhdosh me pyetjet?

Ina Zhupa – Po, se si vazhdoj unë...

Petro Koçi – Vazhdoni pra...

Ina Zhupa – ...do të ma shkruash ti?

Petro Koçi – ...me pyetjet, të lutem shumë!

Ina Zhupa – Zoti Koçi, keni dëshirë të ma shkruajë Fuga apo ju dhe unë të lexoj çfarë të doni ju?!

Petro Koçi – Për hir të solemnitetit parlamentar, ju lutem, konsumoni të gjitha pyetjet që keni përgatitur.

Unë ju thashë, në rast se nga përgjigjet që do të vijnë nga zoti Fuga...

Ina Zhupa – Të pres kur të mbarojnë kolegët e tjerë, ndërkohë që ai nuk më jep mua përgjigje...

Petro Koçi – Të presësh, pra, sepse ti po na thua neve të presim, ndërkohë për vete nuk pret!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, do të presësh, sepse...

Ina Zhupa – Patjetër, sepse logjika është: bëj pyetje dhe marr përgjigje.

Petro Koçi – Konsumoni pyetjet, pra! Madje, po jua them me përulje, ju lutem shumë, konsumoni pyetjet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Zoti Koçi, faleminderit për të drejtën e fjalës, të cilën ma jep Rregullorja!

Unë do të konsumoj pyetjet dhe do të pres përgjigje nga zoti Fuga, në mënyrë të tillë, sepse e kemi ftuar këtu për të marrë përgjigje për pyetjet dhe jo për të dëgjuar monologun tim, monologun e zotit Fuga, ndërkohë ju të vazhdoni me pyetje të tjera dhe ai t'u përgjigjet pyetjeve që do vetë dhe jo atyre të cilave nuk u përgjigjet dot.

Besion Ajazi *(flet pa mikrofon)* - Hajde, tani, se more 10 minuta media!

Ina Zhupa – Zoti Ajazi, qëndro në pozicionin tënd dhe mos bëj zhurmuesin!

Besion Ajazi – E more vëmendjen. Kështu që vazhdo...

Ina Zhupa – Mos ki merak.

Kjo ishte pyetja ime e parë, zoti Fuga. Do t'i përgjigjeni, apo të vijoj me pyetjet e tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – ...nuk e vendos ti atë se kur e merr fjalën zoti Fuga, mbledhjen e drejtoj unë!

Vazhdoni, konsumoni pyetjet.

Ina Zhupa – Nuk do t'i përgjigjeni pyetjes së parë?

Petro Koçi – Edhe një herë, të lutem shumë, vazhdo me pyetjet, sepse po bëhet një lojë pa kuptim!

Ina Zhupa – Zoti Koçi...

Petro Koçi – Do të vazhdojmë siç kemi vazhduar gjithmonë. Të mos bëjmë, kështu, opozitarizëm procedural kot!

Ina Zhupa – ...forma ka po aq rëndësi sa edhe substanca, dhe këtë e di më mirë se kushdo zotëria që keni aty dhe fakti që unë dua përgjigje ndaj çdo pyetjeje që unë bëj, është një e drejtë që ma njuh Rregullorja dhe parlamentarizmi.

Unë nuk kam ardhur këtu që të bëj pyetje dhe të mos marr përgjigje për ato pyetje apo pasi të merret përgjigja, të mos kem mundësi të kundërpërgjigjem dhe të kërkoj edhe informacione shtesë, sepse ndoshta nuk e ka ezauruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zotëri, sepse nuk e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, e kam lexuar, por lexoje edhe ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lexoje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Fuga, këta duan t'ju mbrojnë, por ju mbrohni vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo ishte pyetja ime e parë për të cilën nuk mora përgjigje, por uroj që ta marr më vonë.

E dyta, gjithmonë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, agjencia juaj organizon punën për të përgatitur qëndrime dhe sondazhe qeveritare mbi çështjet me interes publik. Pra, ju, zoti Fuga, me paratë e taksapaguesve shqiptarë bëni sondazhe në shërbim të qeverisë për të manipuluar qytetarët në informacionin që jepni. Pra, paguajnë qytetarët që ju t'i manipuloni.

Çfarë sondazhesh keni bërë deri tani, nëse keni bërë, apo çfarë parashikoni të bëni, sepse ndoshta koha është shumë e shkurtër? Cila është metodologjia e këtyre sondazheve dhe a e klasifikoni si sondazh klikimin *like* dhe *share* në facebook? Në dijeninë tonë, e thënë nga ish-zëvendësministri i Arsimit, Taulant Muka, në mbledhjet e qeverisë diskutohej sa *like* dhe *share* kishin ministrat në profilet e tyre në facebook. A është ky një nga misionet që ka agjencia dhe a bazohen këto sondazhe në rritjen e numrit të *like*-ve dhe *share*-ve të Kryeministrit në facebook?

Kjo është pyetja ime e dytë, të cilës mund të zgjidhni t’i përgjigjeni tani ose në fund, sepse unë nuk e harroj.

Agjencia organizon konferenca për shtyp të ministrave, si dhe e përfaqëson Këshillin e Ministrave ose ata vetë në këto konferenca nëpërmjet zëdhënësve, personave apo personit përkatës. Pyetja është direkte. Nëse ju, zoti Fuga, si drejtor, nuk doni që një ministër të dalë në konferencë për shtyp, ai nuk del, pra, duhet të marrë leje te ju për të dalë në konferencë për shtyp meqenëse ia organizoni ju dhe e vendosni ju, apo i keni dhënë edhe mundësinë që ta kërkojë edhe ai ose ajo dhe pastaj ta gjykoni ju nëse ia vlen ose nuk ia vlen dhe se si duhet të dalë?

Çështja më e rëndësishme për mua është kjo. Këto janë të gjitha kompetenca që unë i lexoj te VKM-ja.

“Vëzhgon publikimet e mediave dhe mjetet e komunikimit masiv për të evidentuar perceptimin, qëndrimin e publikut e të tjera”. Ju vëzhgoni median. E vëzhgoni median në kuptimin që i bëni një fotografim për t’ia dhënë Kryeministrit se kush ka thënë çfarë apo ky fotografim që ju i bëni medias më pas i shërben Kryeministrit për të zgjedhur gazetarët që do të jenë apo nuk do të jenë në konferenca, mediat që do të jenë apo nuk do të jenë në konferenca, mediat të cilave do t’u dërgohet apo nuk do t’u dërgohet informacion? Ju duhet ta dini se në këtë vend ka ndodhur që Kryeministri u ka vendosur sanksione gazetarëve duke i thënë “ty nuk do të përgjigjem për 60 ditë, sepse nuk të kam qejf”, se ndoshta nga vëzhgimet që ju keni bërë i ka dalë se nuk është media që i bën lavde Edi Ramës.

Në kompetencat e agjencisë futet edhe rregullimi i kësaj marrëdhënieje midis Kryeministrit dhe gazetarëve, duke mos lejuar preferenca të Kryeministrit, apo janë pikërisht këto vëzhgime që ju bëni materialet mbi të cilat Kryeministri referohet për përjashtimet që u bën gazetarëve apo mospërgjigjet ndaj gazetarëve në komunikimet e tij me median? Me sa e lexova unë, ju si drejtor i agjencisë, organizoni edhe takimet e Kryeministrit me gazetarët.

E shikoj që nuk doni të përgjigjeni pas çdo pyetjeje, prandaj po kaloj te pyetja tjetër.

“Mban kontaktet e nevojshme me strukturat homologe brenda dhe jashtë vendit dhe nënshkruan protokolle bashkëpunimi me ta”. Cila është struktura juaj homologe në Itali, në Greqi, në Spanjë, në Portugali apo keni zëdhënësit e kryeministrave, sepse, edhe pse ju e krahasoni me Zyrën Federale të Shtypit të Gjermanisë, të krijuar në vitin 1949, ajo nuk ka lidhje fare me atë që bëni ju, me strukturën që keni ju, me kompetencat që keni ju dhe me mbistrukturën që keni ju, dhe që do të arrijmë aty?

Zoti Fuga, në funksionet që ka Zyra Federale e Shtypit, u referohet atyre që nuk u referoheni ju, ka për bazë qytetarët dhe thotë se çdo qytetar dhe çdo qytetare ka të drejtën e informimit, kurse ju keni bazë median, manipulimin e medias, informacionin në media dhe jo qytetarët. Cilat janë strukturat homologe që ju keni në këto shtete që unë ju përmenda, Itali, Greqi, Spanjë, Portugali, në vendet e Bashkimit Europian apo edhe më gjerë?

Unë i kam të shkruara pyetjet, kështu që nuk i harroj, edhe nëse ju i lini pa përgjigje. Kjo lidhet drejtpërdrejtë edhe me komisionin dhe me shqetësimet që vijnë nga mediat.

“Siguron përgjigje për shkresat dhe kërkesat për informacion në lidhje me çështjet e informimit dhe komunikimit mediatik dhe për çështje të tjera të fushës së saj të përgjegjësisë”. Kjo do të thotë se kur një media kërkon një informacion nga një iks ministri, për shembull, një media kërkon informacion nëse po vazhdohet me pagesat e inceneratorëve, ndërkohë që ata janë në arrest, kërkesën për këtë informacion nuk ia drejton ministrisë, që është autoriteti kontraktor, por jua drejton juve dhe ju duhet t’i ktheni përgjigje, apo jo?! Ju nuk përgjigjeni, sepse jeni në kodin e heshtjes, por mund të përgjigjeni më pas.

Unë mora këtë rast, por mund të jenë edhe raste të tjera. Seanca duhej të zhvillohej pyetje – përgjigje, në mënyrë që ju të më jepnit mundësi ta vazhdoja pyetjen siç është, në qoftë se nuk është kështu. Ju tundni kokën, sikur nuk është kështu, por duhet të na e thoni si është, sepse ka lidhje me pyetjet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë që ma kujtuat këtë fakt, zoti drejtues i seancës, sepse, meqë emëroni të gjithë zëdhënësit, mund të kishit vendosur edhe zëdhënësit e partive politike dhe do të ishit më i qetë, sepse nuk do të kishte as denoncime nga opozita.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk besoj se do më kishe mbajtur, sepse unë di vetëm të denoncoj dhe të them të vërtetën; nuk marr dot urdhra.

Zoti Fuga, centralizimi i një informacioni sjell logjikisht edhe zgjatjen në kohë të atij informacioni. E gjithë ideja, edhe kur flitet për pushtet lokal, edhe kur flitet për përgjigje, është decentralizimi, dhënia e informacionit në mënyrë të shpejtë, mundësi që të kenë sa më shumë pika kontakti, në mënyrë që edhe kur nuk e do një person, e do një person tjetër dhe të mos varet as nga dëshirat e ndonjë personi.

Kur i centralizon, zgjatet në kohë edhe si procedurë, sepse edhe sikur ti apo agjencia të ketë vullnetin, është procedura që të gjitha kërkesat vijnë te ju.

Kur nuk kthehet përgjigje, Komisioneri për të Drejtën e Informimit, që ka kontrollin e mospërgjigjeve, ju kontrollon ju dhe jua kërkon juve si agjenci apo ia kërkon ministrisë përkatëse mosdhënien e përgjigjes? Pra, si e gjen komisioneri fajtorin midis agjencisë dhe ministrisë përkatëse ku kërkohet të merret informacion?

Kam edhe një nënpyetje për këtë çështje. Kur një qytetar kërkon të marrë një informacion, në dijeninë time, ia dërgon kërkesën ministrisë përkatëse. Pra, kur unë si qytetare dua të marr një informacion, ia dërgoj kërkesën ministrisë dhe nuk e sjell te agjencia. Kjo mua më bën ta përforcoj mendimin se qëllimi i agjencisë nuk është informimi i publikut dhe i qytetarëve, sepse në qoftë se do të ishte ky, do të kishit marrë edhe të drejtën të informonit qytetarët mbi çështjet e ministrive, por ju keni thelbësisht vetëm një interes: të kontrolloni informacionin që merr media dhe mundësisht të jepni lajme të paracaktuara, duke u lehtësuar punën disa mediave, të cilat e kanë edhe më kollaj ashtu, si dhe të bëni propagandën e qeverisë sa më mirë. Unë këtë kuptoj nga kjo gjë.

Në VKM thuhet se agjencia, dhe këtu jam habitur, për të thënë të drejtën, siguron edukimin qytetar. Termi “siguron” më çudit fare. E siguroni ju edukimin qytetar! Mund të përdornit fjalët “ndihmon në promovimin”, “jep një ndihmesë” e të tjera, por të thoni që agjencia e propagandës e Edi Ramës siguron edukimin qytetar në këtë vend, është të çuditësh duke mos u çuditur, sepse nga ju mund të presësh çdo gjë. Kjo thuhet në VKM: “Agjencia për median siguron edukimin qytetar”.

Petro Koçi – Thotë “në punën e Këshillit të Ministrave”, sepse po ta lexosh shkurt, keqkuptohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa - Patjetër. Doni ta lexoj deri në fund?

Petro Koçi – “Edukimin qytetar me punën e Këshillit të Ministrave”.

Ina Zhupa - Zoti Koçi, lëreni zotin Fuga të flasë vetë, se nuk ishte as pyetje për ju.

Petro Koçi - Ngaqë të kam kolege, nuk dua të gabosh në pyetje.

Ina Zhupa – Faleminderit, por nuk gaboj. Mos ki merak, se nëse gaboj, i marr kostot vetë.

Petro Koçi - Edhe unë të falenderoj për falenderimin!

Ina Zhupa - Të fala paç!

Thuhet se siguron edukimin qytetar me punën e Këshillit të Ministrave dhe të administratës shtetërore në varësi të tij, si dhe organizon një program periodik e të tjera. Pra, siguron edukim qytetar, sepse puna e Këshillit të Ministrave në thelb është gjithçka ndodh në qeverisjen e këtij vendi, pra ai është edukimi qytetar. Këshilli i Ministrave vendos për çdo gjë, për pensionet, për paketën e rezistencës, që po flasim tani e të tjera, rregullat, ligjet, sa dënohet, cili është shërbimi i provës, çdo gjë. Ju faktikisht, agjencia juaj, e siguron edukimin e qytetarëve, se kjo është logjika.

Tani, unë jua thashë në fillim, që kjo është propagandë me para publike, mirëpo ju nuk e keni lënë me kaq. Kur them ju, kam parasysh Ramën.

Te pika 2 thuhet: “Agjencia financohet nga buxheti i shtetit, por edhe nga donacione dhe burime të tjera të ligjshme”. Pyetja ime është: kush parashikohet të vijë të japë donacione për agjencinë e medias që bën propagandën e Kryeministrit, oligarkët, për qëllime të caktuara? Se kush mund të jetë ai që të vijë të japë para, që ju të bëni propagandën e Edi Ramës me qëllime normale të biznesi të tij? Pra, kë parashikoni, kur thoni: donacione dhe burime të tjera financiare?

Edhe një pyetje konkrete, për shembull, duke qenë se unë vetë kam qenë pjesë e një komisioni hetimor, inceneratorët kishin zë sponsorizime në media dhe mund të shtonin edhe një zë, sponsorizime të agjencisë së medias, a do t’i pranoni ju këto financime? A janë të ligjshme këto lloj donacionesh? Domethënë, kjo është ideja e donacioneve, që ata që marrin PPP të vijnë të bëjnë donacione edhe për propagandën? Kjo është pyetja tjetër.

Shpresoj t’i mbani shënim pyetjet. Agjencia juaj ka në strukturën e saj 69 punonjës. A mundet ju, jo sot, por edhe në vijim, të na vini në dispozicion informacionin ku të tregoni se cilët janë punonjësit e kësaj agjencie, për t’i pasur? Mundësisht të na thoni, krahas çdo punonjësi, sa adresa *fake* kanë në *facebook*, në mënyrë të që ta dimë edhe ne kur i shikojmë. Në qoftë se mundeni, këtë të dytën s’e bëni, por të paktën na sillni të parën, emrat e punonjësve të agjencisë.

Pyetja tjetër. Duke qenë se kujdeseni për PR-in, për performancën, për zyrat e shtypit dhe për zëdhënësit e ministrave, kam një pyetje që në fakt më lindi nga seanca e kaluar në Parlament, pasi unë ulem në rreshtin e dytë të sallës, dhe pashë që kur ministrja e kërkoi fjalën për procedurë, e kishte të shkruar, të parapërgatitur fjalën, pavarësisht se çfarë do të thoshte zotëria. Këtë mund t’ua jap me shembull konkret. Elisa Spiropali gjithmonë në Kuvend merr fjalën pas zotit Berisha dhe e ka gati fjalën. Unë nuk e kisha kuptuar që e kishte gati, sepse ajo me elegancë bënte sikur shkruante gjatë kohës që fliste Berisha. Në mungesë të saj, kur ishte në Berlin, Olta Xhaçka nuk e bëri këtë inskenim sikur shkruante dhe doli e lexoi të shkruar atë që duhet të thoshte. Tani, pyetja

ime nuk ka lidhje me rastin konkret, se ndoshta edhe nuk është ashtu, por kështu e perceptova unë. Pyetja ime është: a i bëni ju fjalimet e ministrave? Jo, ju personalisht, por agjencia dhe zyrtarët e shtypit a i përgatisin fjalimet e ministrave për në Parlament? Meqenëse edhe ajo është pjesë e PR-it, e propagandës, e fjalimeve.

Për shembull, është një togfjalësh zoti Fuga, që e thonë të gjithë “dy fatkeqësi të mëdha, tërmeti dhe pandemia tregojnë se qeveria jonë e gatshme dhe e vetmja” e të tjera. Këtë e kanë të gjithë në fjalimet e tyre dhe ndoshta mos e kanë *copy paste*, nga agjencia e propagandës?

Pyetja tjetër. Në konferencën e fundit, Kryeministri tha që ka një pakt me median, se çfarë duhet të transmetojë media. Në fakt, lexova edhe një artikull të BIRN-it që e kishte evidentuar këtë, që ekzistonte një pakt me median se çfarë duhet të transmetojë media. E para, a është i vërtetë ky pakt? E dyta, a keni ju sot një pakt me median sesi do t’ju transmetojë ju në komision, se si do të lartësohet figura e agjencisë, ndoshta edhe figura juaja, dhe si do të dalim ne të paditurit e këtij komisioni?

Dhe pyetja e fundit për momentin, sepse i rezervoj vetes të drejtën që mbas përgjigjeve tuaja të kem mundësi të bëj pyetje të tjera, në qoftë se nuk jam sqaruar, sepse kjo është edhe arsyeja pse jemi këtu. Në total, nëse ju keni një shifër, sa është buxheti, sa para paguhen nga buxheti i shtetit për agjencinë? Pa llogaritur ato që unë ju pyeta më parë, që do të përgjigjeni dhe do na thoni që tani s’janë, por mund të jenë. Sa harxhohet nga buxheti i shtetit për ministrinë e propagandës? Që ta dimë edhe ne. Sa para harxhohen për momentin? Se mund të ndryshojë shuma vit pas viti, se ju mund të shtoni strukturën, mund ta shkurtoni atë, por për momentin. Sepse, me sa vura re, unë të paktën, nga ajo që lexova, kishte një miksime buxhetesh që ishin parashikuar për ministrinë, për këto zyra shtypi. Një pjesë e buxhetit që ishte parashikuar për ATSH-në, do t’i kalonte agjencisë, por unë nuk jam në dijeni, nga shkresa të paktën, se sa shkon shifra në total, buxheti në total që kërkon një agjenci e tillë me 69 punonjës.

Gjithashtu, ajo që unë lexoj është se këta punonjës nuk kanë, dhe këtë mund të ma sqaroni ju gjithmonë, statusin e nëpunësit civil, por punojnë sipas Kodit të Punës. Kjo e bën më të lehtë për ju të hiqni dhe të vini në agjenci kë të doni, sepse nuk është se kanë ndonjë mbrojtje apo kalojnë në ndonjë konkurs, por është vullneti i drejtorit të përgjithshëm apo i nëndrejtorit, zëvendës-drejtorit për të bërë këtë gjë.

Së fundi, për ta mbyllur. Zoti Fuga, liria e informacionit është e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe besoj se ju këtë e dini. Agjencia

juaj, agjencia që ju përfaqësoni, jo juaja, bën gjithçka përveç se garanton të drejtën e informimit në këtë vend.

Këto ishin pyetjet e mia të para. Uroj të marr përgjigje për të gjitha.

Faleminderit!

Petro Koçi - Faleminderit, zonja Zhupa!

Zoti Fuga, siç thashë edhe në fillim, të bëjmë një pakt lidhur me përgjigjet; të jenë sa më teknike, jashtë reagimeve ndaj gjuhës polike, që në një pjesë të pyetjeve ishte edhe diskriminuese, siç ishte ajo për gjoja hartimin e fjalimeve të ministrave në Kuvend, për të cilën mendoj se nuk meriton përgjigje.

Ina Zhupa - Mos komento pyetjet e mia, se nuk e ke këtë tagër.

Petro Koçi - Të lutem shumë.

Ina Zhupa – Jo, të lutem shumë, s'e ke fare tagrin të komentosh pyetjet e mia.

Petro Koçi - Mirë, mirë.

Ina Zhupa – Nuk e ke këtë tagër.

Petro Koçi - Ka mundësi të bëhesh e sjellshme tani?

Ina Zhupa – Ka mundësi të respektoni Rregulloren?

Petro Koçi - Se po e tepron në mënyrë të jashtëzakonshme.

Ina Zhupa – Ka mundësi të respektoni Rregulloren?

Petro Koçi - Edhe një herë, të lutem shumë!

Ina Zhupa – Mos komento pyetjet e mia.

Petro Koçi - Edhe një herë thashë, nuk është në dinjitetin e këtij komisioni, që të dëgjojmë shprehje diskriminuese për të tjerët që s'janë prezent këtu, siç është ajo që thatë për hartimin gjoja të fjalimeve të ministrave.

Ina Zhupa – Po pyes zotërinë, ju mos komentoni pyetjen time.

Petro Koçi - Nuk po të flas ty fare, një herë.

Ina Zhupa – Mos komento pyetjen time.

Petro Koçi - Po i kërkoj zotit Fuga...

Ina Zhupa – Mos komento pyetjen time dhe unë nuk do flas.

Petro Koçi - Edhe një herë, s'e çdo them unë, nuk të marr leje ty. Dakord?

Ina Zhupa – Kur më komenton mua, prit përgjigjet nga unë. Mos komento.

Petro Koçi – Atëherë, të vazhdojmë me përgjigjet, sigurisht me qartësinë që ky institucion i ngritur nga VKM-ja nuk mund të ngatërrohet fare as me letrat e qytetarëve që venë në zyrat e shtetit, as me institucionin e Komisionerit për të drejtën e Informimit.

Ju lutem, zoti Fuga, përgjigjet të jenë teknike!

Endri Fuga – Faleminderit kryetar!

Unë do të mundohem të jem sa më konciz

Në fakt, dua të bëj vetëm një parashtrësë, unë këtu kam ardhur për t'ju respektuar të gjithëve. Jam i ftuar në këtë komision për dëgjuesë dhe do të kisha dashur që në 45-minutëshin e parë të kisha pasur më shumë kohë për t'u dëgjuar sesa për të dëgjuar, por unë do të tentoj të jem sa më konciz në përgjigje.

Jam i bindur, zonja Zhupa, që nuk do t'ju zhgënjej, sepse pyetjeve do u përgjigjem një e nga një, sigurisht pastaj në bazë rregullave që ju keni mund të marr pyetje të tjera.

Përpara sesa të filloj me pyetjet specifike, ka një gjë që më bën përshtypje, që në fakt deri diku e prisja dhe isha i përgatitur, është një gjë që ka ndodhur që nga shtatori, në mos gaboj mesi i shtatorit, kur Këshilli i Ministrave vendosi për ngritjen e agjencisë, jo për nisjen e punës së agjencisë, sepse janë dy momente të ndryshme. Agjencia ka nisur punë 3 muaj më parë, ndërkohë në shtator është vendosur që agjencia të krijohet, dhe gjëja që, më gjithë respektin, mund ta quaj absurde, është që problematika erdhi nga të gjithë ata njerëz nuk kanë asnjë lidhje me agjencinë. Pra, në raportin tim, në raportin tonë, në raportin e agjencisë me gazetarët ne nuk kemi pasur asnjë lloj problematike, puna ka vazhduar si më parë, unë mund t'ju rendis disa gjera, të cilat, në këndvështrimin tonë, janë përmirsuar dhe problematikën që e parashtrroi zonja Zhupa unë e kam dëgjuar vetëm nga përfaqësuese politik. Të mos keqkuptohemi, është plotësisht e drejta juaj që ta bëni, por, fatmirësisht, puna jonë nuk është me ju, por është me ata që janë ulur në rreshtin mbrapa dhe prej tyre nuk është dëgjuar një problematikë e tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë ju thashë, ju keni të gjithë të drejtën që t'i ngrini këto shqetësime dhe unë jam këtu për t'iu përgjigjur këtyre shqetësimeve. E vetmja gjë që unë kërkoj është që të kemi një komunikim sa më normal, sepse unë këtu e konsideroj veten të ftuar dhe e konsideroj mikun tuaj, jo armikun.

Gjithsesi, për t' marrë gjerat me radhë. Në pyetjen tuaj të parë ju folët për rolin e zëdhënësive, ju folët për ministri, për ministër dhe për propagandë. Unë dua shumë shkurt t'ju sqaroj për këtë.

Së pari, fjala propagandë është përdorur, unë mbaj mend, prej 15 vjetësh, kaq kam unë që punoj me medien, dhe nuk është një fjalë që është përdorur rishtazi që kur është ngritur Agjencia, pasi Agjencia ka 3 muaj që është ngritur dhe kjo fjalë nga opozita apo të tjerë përfaqësues të partive politike ka 15 vjet që përdoret. Kjo nuk ka asnjë problem, por më bën përshtypje që e lidhin fjalën propagandë me Agjencinë, ndërkohë që fjala propagandë ka vite që është një akuzë e përsëritur dhe e përsëritur dhe, në këndvështrimin tim, nuk ka lidhje fare me Agjencinë.

Së dyti, unë jam emëruar drejtor i agjencisë. Kjo është hera ime e parë që unë vij në Kuvend, nuk kam funksione të tjera dhe lidhje të tjera me Kuvendin apo me institucione të tjera që shkojnë përtej detyrës sime si drejtor i Agjencisë. Për të qenë i sinqertë deri në fund, kemi të bëjmë me një agjenci modeste, qoftë nga numri i punonjësve, qoftë nga buxheti, dhe unë do të shkoj atje, qoftë për nga asetet. Kjo nuk është një agjenci e madhe për të merituar gjithë këtë vëmendje, gjithsesi, kjo është sërish është e drejta juaj. se cilat janë arsyet që VKM-ja është shkruar në një formë apo në një formë tjetër, se cilat janë arsyet që drejtori i agjencisë ka një rol të caktuar, apo një rol tjetër, këto janë pyetje, të cilat unë do t'ia lë të përgjigjet kolegja ime, sepse kjo nuk është një vendimmarrje imja. Unë përgjigjem për funksionimin e agjencisë që nga momenti që agjencia është krijuar e tutje.

Kjo Agjenci ka marrë për bazë një model, nuk është një shpikje e shqiptarëve. Qoftë misioni, qoftë funksione, qoftë ndarja në departamente janë të marra nga një model, që nuk është i panjohur, por është modeli gjerman i agjencisë federale për shtypin dhe për informimin.

Pyetja e dytë ka të bëjë me sondazhet. Në këto tre muaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të flas edhe për zëdhënëset dhe mund t'ju përgjigjem edhe tani. Aktualisht, në momentin në të cilin jemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk i kam fare problem ndërhyrjet, sepse ndodh që në dy faqe pyetje të shpëtojnë gjëra.

Në raport me zëdhënësit, zëdhënësit janë të ministrive, janë njerëz, të cilët do të vazhdojnë e të punojnë në ministri, janë njerëz të cilët do të vazhdojnë të kryejnë të njëjtin funksion që kanë kryer deri tani për ministrat dhe ministrinë, janë njerëz që do të vazhdojnë të mbajnë në mënyrë të përditshme marrëdhëniet me medien e shkruar, elektronike, vendase apo të huaj për secilën prej ministrive. Secili prej gazetarëve që janë të pranishëm këtu apo nuk janë në momentin që ka një

pyetje për një ministri të caktuar, ka mundësinë dhe ka të gjithë të drejtën t'i drejtohet automatikisht zëdhënësit të asaj ministrie. Në momentin, në të cilin ne jemi, rreth 3 javë më parë mos qofsha i gabuar, i kam drejtuar një shkresë çdo ministrie, në të cilën i kërkoj përcaktimin e presonit, i cili ka rolin e zëdhënësit apo të personelit përgjegjës për raportet me medien, në mënyrë që këta njerëz të kenë mundësinë të koordinohen më mirë. Ka çështje, të cilat lidhen me një ministri të caktuar dhe vetëm për këto çështje që lidhen vetëm me një ministri të caktuar nuk ka asnjë problem, vazhdon e njëjta gjë që vazhdonte edhe më parë, por ka çështje të caktuara që nuk lidhen vetëm me një ministri. Sot që ne flasim ka çështje që kanë të bëjnë me paketën e rezistencës, apo çështje të tjera, të cilat nuk janë tagër i një ministrie të vetme, por janë çështje që lidhen me disa ministri, shpeshherë nuk janë as vetë ministri, por janë institucione varësie dhe për këtë rast ishte e tmerrshme për gazetarët që duhet të drejtoheshin 10 personave të ndryshëm, të cilët ishin të pakoordinuar, njëri jepte përgjigje sot, tjetri nesër, tjetri nuk jepte përgjigje fare. Kjo sot është më e thjeshtë për gazetarët, të cilët i drejtohen...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Zhupa, më vjen keq, ju lutem më dëgjon! Merruni më pak me telefonin dhe më dëgjoni, sepse jua ktheva këtë përgjigje. Ju thashë, që aktualisht ka rreth tri javë që i kam dërguar një kërkesë secilit prej ministrive, ku i kërkoj të më vënë në dispozicion se cili është zëdhënësi i çdo ministrie. E përkthyer më thjeshtë, kjo do të thotë që nuk jam unë i vetmi person që emëroj. Në momentin që unë kam një përgjigje, unë bëj emërimin administrativ, por ama procedura është kjo që po ju shpjegoj tani.

Lidhur me çështjen e sondazheve, në këto kemi 3 muaj nuk kemi zhvilluar asnjë sondazh. Me të drejtë ju mund të thoni që mund të zhvillojmë sondazhe në të ardhmen dhe është e vërtetë, por në asnjë rast nuk do të jenë sondazhe politike. Me të drejtë ju mund të pyesni se çfarë sondazhesh mund të jenë dhe unë po ju jap një shembull, qytetarët nuk do të shkojnë më për të marrë një shërbim të caktuar në sportelet fizike, po këtë shërbim do ta marrin online. Ky është një vendim i qeverisë dhe ne duam të kuptojmë ky vendim i ka shërbyer qytetarëve apo jo, qytetarët janë më komod me shërbimin online apo në sportel tradicional. Ky mund të ishte një model sondazhi, i cili do të zhvillohet nga agjencia. Për momentin nuk ka asnjë sondazh të zhvilluar deri sot.

Pyetja tjetër ishte përsëri për zëdhënësit e ministrive, nëse dalin me lej apo nëse dalin pa leje, kush vendos për daljen e tyre dhe kush shkruan çfarë. Jua thashë edhe një herë që zëdhënësit

bëjnë të njëjtën punë që bënin edhe përpara dhe e vetmja gjë që ka ndryshuar është që ka një koordinim më të mirë për çështje, të cilat prekin disa ministri bashkë, nuk ndryshime të tjera.

Pyetja e katërt ka të bëjë me monitorimin dhe vëzhgimin e medias, që sërisht ishte pjesë e prezantimit tim. Është një prej drejtorive të agjencisë, por sërisht edhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një shpikje, por kemi të bëjmë me një model, i cili besoj se vlen për gjithkënd. Pra, nëse ka një gjë, të cilën të gjithë e bëjnë është monitorimi i medias në kuptimin e saj se çfarë ndodh. Këtë e bëjnë ministrinë, këtë e bëjnë qeverinë, këtë e bëjnë institucionet, këtë e bëjnë partinë, këtë e bëjnë ambasadat, këtë e bëjnë bizneset, këtë e bëjnë kushdo. Edhe në këtë pikë ne kemi marrë për shembull Agjencinë Federale të Shtypit dhe Informimit, është e njëjta metodologji dhe nuk kemi të bëjmë me vëzhgime konspirative, por kemi të bëjmë me një gjë që unë jam i sigurt se edhe ju vetë në punën tuaj të mëparshme, si zëdhënëse e partisë Demokratike, keni bërë gjithashtu dhe jam i bindur në këtë gjë. Jam i bindur që puna juaj si zëdhënëse e Partisë Demokratike fillonte duke shfletuar gazetat dhe çfarë shkruajnë gazetat dhe më pas ju raportoni cilat ishin çështjet kryesore, çfarë flitej nëpër emisione, cilat janë lajmet e të tjerë. Kjo bëhet për një arsye të thjeshtë, sepse, në fund fare, misioni i gazetarëve dhe i medias është që të përçojnë problematikën dhe shqetësimet e qytetarëve. Një qeveri duhet të jetë e informuar për problematikën dhe aktualitetin se çfarë ndodh, në mënyrë që të përgjigjet sa më shpejt dhe në kohë dhe të jetë sa më pranë qytetarëve.

Në pyetje ju iu referuat edhe një rasti specifik dhe nuk dua ta anashkaloj, sepse është një rast që ka të bëjë me gazetaren e Syri Televizion. Unë në punën time jam në kontakt me të gjithë gazetarët dhe me të gjithë drejtuesit e medias, përfshirë edhe me personat në fjalë. Unë jam në komunikim të vazhdueshëm me ta dhe e di shpeshherë ka pasur problematikë, jo vetëm nga ana jonë, por edhe nga ana juaj me televizionin në fjalë, por unë personalisht ruaj raporte plotësisht profesionale, madje, gazetarja në fjalë ishte e ftuar para dy ditësh në Berlin , ku ishim bashkë me Kryeministrin, atje patëm disa gazetarë dhe gazetarja në fjalë ishte e ftuar, por po të mos ishte për një mungesë dokumentacioni që lidhej plotësisht me të, ajo do të ishte një prej personave të ftuar nga ne. Gjithsesi, unë besoj se respekti duhet të jetë i ndërsjellët, pra, nga njëra anë politikanët duhet të tregojnë respekt ndaj gazetarëve që t'u përgjigjen pyetjeve që ata bëjnë dhe, nga ana tjetër, edhe gazetarët duhet të tregojnë respekt ndaj politikanëve që t'i lënë dhe t'u përgjigjen pyetjeve që ata vetë kanë bërë. Kjo është e ndërsjellët.

Lidhur me pyetjen për strukturat homologe, këtu është një moment, në të cilin dua të ndalem. Jua thashë edhe në fillim, me kemi marrë për bazë zyrën federale të shtypit në Gjermani,

kemi zhvilluar edhe disa vizita atje, kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm qoftë me drejtorin, zëdhënësin sekretarin e shtetit të drejtorisë në kohën e mëparshme, zotin Stefan Zaibert, qoftë tani me personin e ri që ka ardhur pas ndryshimit të kancelarit në gjermani. Edhe në modelin gjerman aplikohen të njëjtat funksione. Po t'i lexoni, edhe ata tri qëllime kryesore kanë: informimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve; informimin e medias dhe informimin e qeverisë. Unë mund t'jua vë në dispozicion në fund të kësaj mbledhjeje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju nuk e keni, sepse unë jua them me përgjegjësi këtë gjë dhe mund t'jua vë në dispozicion që ta shihni, por të mos e kthejmë në debat.

Gjithsesi, ka disa ndryshime nga modeli gjerman, ku në atë periudhë jemi treguar më të kujdesshëm dhe ndryshimi kryesor është, e para, numri i punonjësve dhe buxhetet, sepse Agjencia Federale ka një buxhet që ne kemi vetëm 1% të buxhetit të tyre. Ata kanë zyra të shpërndara në të gjithë Gjermaninë, kanë rreth 700 punonjës të shpërndarë në Berlin dhe në Bon dhe ne nuk mund të krahasohemi, por ndryshimi që kemi bërë është që në zyrën Federale Gjermane të gjitha buxhetet që lidhen me fushata ndergjegjësuere të misnitrive kalonin te Agjencia Federale Gjermane dhe ishin ata që bënin menaxhimin e buxhetit të fushatave, që pastaj shkonte në medie. Në rastin në fjalë, ne këtë pjesë nuk e kemi prekur fare, e kemi lënë siç është nëpër ministri, në mënyrë që të mos krijonim asnjë lloj keqkuptimi. Kur vjen puna për shtypin e shkruar, ne, si qeveri, kemi marrë një vendim që të mos ketë fare buxhete reklamë për shtypin e shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t'ju shpjegoj më vonë edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Zhupa, ka, por mua më vjen keq vetëm për një gjë: në qoftë se unë do t'ju kisha dhënë për model një vend në Afrikën e largët do e kuptoja pyetjen tuaj, por unë në qoftë se do t'ju jap për model, i cili është një model mot a mot, modelin gjerman dhe ju jeni e pakënaqur me këtë model, ju keni të drejtën tuaj, por unë jam i kënaqur. Në qoftë se agjencia arrin të performojë si modeli gjerman, unë do të isha i lumtur, jo i kënaqur.

Pyetja tjetër ka të bëjë me centralizimin e përgjigjeve, zgjatet në kohë, besoj se këto jua sqarova.

Pyetjet që kanë të bëjnë me ministri të caktuara, gazetarët kanë mundësinë dhe të drejtën e plotë që t'i drejtojnë te zëdhënësit e tyre. Unë ju falënderoj për këtë mundësi, sepse është një

mundësi që të sqarohet edhe gjëra, të cilat mund të ketë edhe të tjerë që mund të jenë të paqartë. Funkcioni i zëdhënësve të ministrisë vazhdon të jetë i njëjti. Në rastet kur kemi të bëjmë me çështje, të cilat janë më të komplikuar, sepse prekin disa institucione, atëherë, unë mendoj se agjencia në vetvete shërben për të shkurtuar kohë dhe jo për të zgjatur.

Pyetja tjetër lidhur me financimet apo donacionet, ne nuk kemi për momentin ndonjë financim apo ndonjë donacion përtej buxhetit të shtetit. Nëse më lejoni, këtë pyetje ta bashkoj me pyetjen tuaj të fundit që kishte të bënte me buxhetin. Ne funksionojmë në bazë të buxhetit të shtetit, por ka një diferencë, sepse buxheti është parashikuar përpara se Agjencia të fillonte funksionin. Në të vërtetë, duke pasur parasysh edhe luftën në Ukrainë, ne pretendojmë që shpenzimet e Agjencisë në fund të këtij viti të jenë shumë më të ulëta krahasuar me ato, të cilat ishin parashikuar përpara se Agjencia të fillonte funksionin. Po jap një shembull një zë në buxhet, që është zëri për qira apo rikonstrukcion godine. Aktualisht jemi me zyra te Pallati i Kongreseve në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe në bazë të një VKM-je qiraja është zero, paguhen vetëm shpenzimet e pastrimit, dritave dhe interneti. Duke qenë se nga vetë Ministria e Financave kemi pasur një kërkesë për të ulur shpenzimet, këto janë shpenzime, të cilat, me rishikimin e buxhetit që ndodh në mes të vitit, sigurisht do të shkojnë për zëra të tjerë, të cilët janë më prioritare. E njëjta gjë ndodh me mjetet lëvizëse. Ne kemi bërë një transferim kapitali përsëri nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në mënyrë që të mos kemi shpenzime.

Zëri kryesor i buxhetit janë pagat dhe sigurimet shoqërore. Këtu më duhet të sqarohet se 2/3 e punonjësve janë persona të transferuar nga institucione të tjera. Pra, nuk kemi të bëjmë me 69 veta, të cilat janë një strukturë e shtuar që i rëndon buxhetit të shtetit, 2/3 e këtij numri janë njerëz, të cilët deri dje paguheshin në pozicione të tjera, kryesisht, në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, rreth 15 vetë, të cilët punonin në ministrinë përkatëse dhe në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, ku një pjesë shkuan pas vitit 2017, kur u shkri Departamenti i Komunikimit në Kryeministri, disa persona, përfshirë edhe veten time, ishin të punësuar në Kryeministri në rolin e këshilltarëve apo ndihmesave. Të vetmit persona që janë shtuar janë personat, të cilët lidhen me miradministrimin e resurse, pra, financë, juristë që ligji i kërkon të jenë pjesë e çdo agjencie.

Petro Koçi- Në një pyetje zonja Zhupa interesohet për donacionet, nëse ka oligarkë, po marrim rastin më të keq.

Endri Fuga - Të jeni të qetë për këtë gjë. Sigurisht, shpeshherë njeriu mendon se tjetri mund të bëjë gjëra që i ke bërë vetë, por nuk i besoj se është ky rasti. Ashtu siç nuk është rasti për

ju, nuk është as për Agjencinë. Këto kanë të bëjnë me fonde, grante, të cilat mund të jenë nga agjenci ndërkombëtare. Për shembull, jo më lart se sa para dy ditësh pashë një njoftim që NATO-ja bënte për fushata ndërgjegjësimi për të hedhur dritë për lajmet e rreme, të cilat vinin në vende anëtare, kryesisht nga Rusia, dhe kishin thirrje për të dhënë grante për të mbështetur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, në këtë rast ishte NATO-ja. Unë nuk e di nëse është aplikuar dhe nëse do të aplikojmë apo nëse e kemi të drejtën për të aplikuar apo jo, por bëhet fjalë për gjëra të tilla.

Ju thatë se, meqenëse ministrat në Kuvend shpeshherë përdorin gjuhë të ngjashme, atëherë i bie që e ka bërë agjencia. Besoj se edhe opozita përdor një gjuhë të ngjashme, por nuk besoj se ka ndonjë agjenci.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj po them, nuk ka lidhje fare me agjencinë. Unë jua thashë, sigurisht, ministrat kanë ekipet e tyre, të cilat punojnë, por në rastin konkret jo. Nëse më pyesni a ishte agjencia që ka përgatitur replikën e zonjës Xhaçka teksa zonja Spiropali ishte në Berlin me Kryeministrin, përgjigja është jo, nuk është ky rasti. Në një moment të caktuar edhe mund të jetë. Drejtoria e Hulumtimit dhe e Përmbajtjes, sigurisht, zhvillon punë kërkimore, nxjerr pika të caktuara, të cilat u shpërndahen ministrave dhe kjo është një punë që ka të bëjë me koordinimin dhe nuk kemi pse ta fshehim, por nuk është ky rasti konkret.

Më pyetët për paktin, paktin unë e sqarova. Patëm një komunikim me gazetaren e BIRN-it. Nuk ka një pakt të shkruar, ka një pakt dhe Kryeministri ka folur për një pakt normal, siç është ai që ne bëmë sot me njëri-tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund ta kishim bërë, por bëmë një pakt tjetër që do të respektonim njëri-tjetrin në përgjigje. Ky nuk është një pakt i shkruar. Ky është një pakt normal në respekt të dy njerëzve që janë këtu për ta dëgjuar njëri-tjetrin, jo kundërshtarë. Unë të paktën nuk kam ardhur këtu si kundërshtari juaj. Dua të theksoj një gjë: do të isha shumë i lumtur që agjencia të qëndronte dhe t'i mbijetonte kohës. Edhe ju, kur të jetë koha, të keni mundësi që ta shikoni nga afër dhe ta shfrytëzoni agjencinë, sepse është një mënyrë e strukturuar për të bërë një punë, e cila është në dobi të publikut në radhë të parë dhe të gazetarëve, së dyti, por sigurisht, edhe në dobi të qeverisë, e cila kërkon t'i komunikojë në mënyrë sa më transparente dhe të plotë mesazhet dhe vendimet e saj.

Pyetjes së fundit, e cila ka të bëjë me buxhetin, besoj se iu përgjigja. Me lejen e kryetarit dua që t'ia kaloj fjalën edhe zonjës Kokona për disa plotësime për çështjet procedurale.

Faleminderit!

Petro Koçi – Zonja Kokona, fjala për ju, në respekt të pyetjeve, ajo pjesë që ju përket juve, sidomos në momentin kur është strukturuar vendimi i Këshillit të Ministrave e të tjera.

Elira Kokona – Faleminderit, zoti Koçi!

Në fakt, pjesa më e mirë e pyetjeve kishin të bënin me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave që krijon agjencinë, vendim, i cili, siç e përmendi edhe drejtori, është miratuar përpara se zoti Fuga të emërohej drejtor i kësaj agjencie. Kështu që ka të bëjë pikërisht me punën paraprake që kanë bërë departamenti që unë drejtoj dhe ministritë linjës, të cilat kanë dhënë mendim për miratimin e këtij vendimi të Këshillit të Ministrave për të arritur dhe për të konkluduar në këtë akt të qeverisë. Po, është e vërtetë, Këshilli i Ministrave, duke u bazuar në kompetencën e akorduar nga ligji nr. 90/2012, ka mundësinë për të organizuar, për të ngritur dhe për të mbyllur institucione publike, të cilat janë në varësi të institucioneve të karakterit kushtetues, siç është rasti konkret, Kryeministria apo ministritë e linjës. Kjo nuk është një praktikë që zhvillohet vetëm në rastin konkret, është një praktikë që zhvillohet në mënyrë konstante dhe zhvillohet në vite. Baza ligjore e aktit, të cilit i referohemi, siç ju përmenda, referohet si në nenet e Kushtetutës, ashtu edhe në nene specifike të ligjit nr. 90/2012 dhe nuk e di nëse ka nevojë të citohen në mënyrë specifike, por janë pjesë e relacionit dhe e aktit, i cili tashmë është publik.

Zonja Zhupa iu referua në disa nga pyetjet e saj faktit se zëdhënësit ishin zëdhënës partiakë, pra zëdhënës të personave që përfaqësonin parti specifike dhe shembulli që ajo drejtoi ishte rasti kur qeveria përbëhet edhe nga koalicionet, të cilat vinin nga forca të ndryshme politike. Pyetja ishte e saktë dhe është e vërtetë. Në fakt kjo është arsyeja pse ka nevojë për një strukturë të tillë, e cila duhet të shkojë përtej interesave të një partie specifike dhe, në fakt, duhet t'u referohet programit qeverisës, funksioneve të qeverisës dhe funksioneve dhe aktiviteteve specifike të organeve kushtetuese, siç janë Këshilli i Ministrave dhe ministritë.

Në fakt, në të gjitha pyetjet që zonja deputete përmendi, të listuara në kompetencat e agjencisë, u lanë pa lexuar ato që u referoheshin publikimit të aktiviteteve të funksioneve të organeve shtetërore apo monitorimi specifik i medieve që i referohen mënyrës se si publikohen këto aktivitete shtetërore. Unë mund t'i citoj të gjitha pyetjet një nga një.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Nëse ka interes, do t'i lexojmë së bashku, por unë po mundohem të jap përgjigjen specifike. Kjo ishte në kontekstin e përgjithshëm pse zëdhënësit nuk janë persona që duhet t'i referohen një individ, por janë persona që u referohen organeve kushtetuese dhe organet kushtetuese, janë ministrat dhe institucionet përkatëse, siç është rasti i Këshillit të Ministrave. Pse është bërë parashikimi që... Nuk është drejtori i agjencisë me statusin e ministrit të shtetit, është cilësia që mbart drejtori i agjencisë, si zëdhënës i Këshillit të Ministrave, që e ngre atë në nivelin e statusit të ministrit të Shtetit, sepse nuk është e njëjta gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kuptoj që është shumë teknike, por po ju referoj, në qoftë se drejtori i Përgjithshëm i agjencisë nuk do të ishte zëdhënësi i Këshillit të Ministrave, atëherë nuk do të kishte edhe cilësitë e statusit të ministrit të Shtetit.

Në fakt, zoti Fuga përmendi modelin gjerman. Në momentin kur kemi hartuar aktin e qeverisë, u jemi referuar disa modeleve. Unë këtu kam marrë me vete modelin italian. Modeli italian i referohet një strukture të përqendruar në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Italisë. Në fakt, drejtohet nga një person, i cili është i përcaktuar me një vendim publik sot si “*Segretario di Stato alla Presidenza del Consiglio dei Ministri*”, pra ka të njëjtin rang, siç është rangi i ministrit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë. Modelet e përmenda janë të ngjashëm. Për shembull, në rastin e Italisë, siç e përmendi edhe zoti Fuga, modelet janë marr si referencë, por nuk e kanë kopjuar idenë. Në rastin e Italisë struktura në varësi të Këshillit të Ministrave përmban edhe editorinë, merret edhe me publikimet. Pra, është një strukturë, e cila përqendron jo vetëm informacionin, por edhe publikimet specifike të të gjitha organeve kushtetuese në varësi të Këshillit të Ministrave. Dokumenti është publik, e gjeni kudo. Unë i jam referuar dokumentit të vitit 2014, por në vijim mund t'u referoheni edhe dokumenteve të tjera. Ky është, në mos gaboj, i 26 marsit 2016 dhe është vendim i qeverisë italiane. Struktura si kjo, siç e përmenda, nuk është vetëm ajo gjermane, por këtu kam sjellë edhe atë italiane. Arsyeja pse zëdhënësit e Këshillit të Ministrave kanë statusin ministrit të shtetit është vetëm për efekt të reciprociteti të koordinimit që këto agjenci kanë me njëra-tjetrën dhe për krijimin e një cilësie specifike të koordinimit të punës të secilit prej tyre.

Po i kthehem pyetjes së dytë. Zonja iu referua faktit nëse është e drejtë që taksapaguesit shqiptarë të mund të paguajnë në lidhje me sondazhet. Ajo e përmendi faktin e manipulimit, por unë do t'i referohem sondazhit. Po, është e vërtetë që agjencia, si çdo entitet publik, është

institucion buxhetor, paguhet nga buxheti i shtetit, pra merr referenca vetëm nga buxheti i shtetit, në zbatim edhe të ligjit për menaxhimin dhe funksionimin e buxhetit të shtetit, nuk është institucioni me vetëfinancim, nuk siguron financime të ndryshme nga ai i buxhetit të shtetit. Është e vërtetë që paguhet nga taksapaguesit shqiptarë, si çdo institucion tjetër publik, i cili ndjek e përndjek interesa të ligjshme, referuar edhe aktit që keni përpara. Sondazhet nuk janë të personave publikë të bëra individualisht dhe as për interesa të partive, që janë pjesë e koalicioneve qeverisëse, u referohen punëve publike, aktiviteteve publike, sidomos akteve publike. Në lidhje me këtë, dua të shtoj se nuk është hera e parë që ndodhin vetëm sondazhe. Mjetet për të referuar perceptimin e publikut apo marrjen dhe mbledhjen e informacionit në lidhje me çfarë mendon publiku për mënyrën se si qeveriset, për mënyrën e politikëbërjes, për mënyrën e akteve janë në disa formate dhe modele të ndryshme. Unë mund t'u referohem si konsultimit publik të akteve, pra në nivelin kur ato janë akteve, ashtu edhe në këshillimit, përpara se politikëbërja të marrë një formë dhe formim të caktuar. Ndër të tjera, mjet tjetër është mbledhja e perceptimeve apo edhe opinionit të publikut në momentin që këto politikëbërje, këto projektakte ose akte dhe iniciativa qeverisëse fillojnë të zbatohen, madje duhet të jetë detyrë e institucionit publik që jo vetëm ta identifikojë politikëbërjen, ta transpozojë atë në një akt publik, por edhe të monitorojë mënyrën se si kjo perceptohet, zbatohet dhe realizohet nga institucioni publik, por edhe nga ata, të cilët janë përfituesit e zbatimit të këtyre akteve publike. Ky është qëllimi, referuar edhe në kompetencat e agjencisë.

Një pyetje tjetër që mendoj se mund të jetë me interes, në pikën “N” të nenit 10 të vendimit, i cili parashikon funksionet dhe detyrat e agjencisë, u përmend fakti i vëzhgimit të medieve. Në fakt, nuk është vëzhgim i mediave. Dua të citoj ekzaktësisht se është “vëzhgim i publikimeve të medieve dhe të mjeteve të komunikimit masiv” dhe nuk lejohet të vëzhgohet për kuriozitet, por ligjvënësi, në rastin konkret Këshilli i Ministrave, e ka përcaktuar shumë qartë nevojën dhe përdorimin e këtyre vëzhgimeve që janë vetëm për të evidentuar perceptimin dhe qëndrimin e publikut ndaj veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore. Nuk kanë të bëjnë me perceptimin e publikut në lidhje me individët apo perceptimin e publikut në lidhje me programe specifike politike, por insistoj të them, vëzhgon publikimet vetëm me këtë qëllim dhe vetëm me këtë nevojë përdorimi. I referohem, gjithashtu, një pyetje tjetër, e cila ka të bëjë me përgjigjen e shkresave, që është pika “N” në rastin konkret të nenit 10 të VKM-së. Citoj: “Siguron përgjigje për shkresat dhe kërkesat për informacion dhe jo ato të përgjithshme”, se u referua këtu

për një çështje të përgjithshme. Për çështjet e përgjithshme ministrinë vazhdojnë, qytetarët apo subjektet vazhdojnë t'i drejtohen kujt do entiteti publik, duke përfshirë edhe agjencinë, i cili ka detyrimin, në bazë të ligjit për informimin publik, për të dhënë përgjigje për çështje specifike të fushës së vet të përgjegjësisë. Në rastin konkret, kjo pikë u referohet vetëm atyre shkresave që kanë të bëjnë me çështje të informimit dhe të komunikimit mediatic. Pra, nuk kanë të bëjnë me çështje, të cilat janë të fushës së përgjegjësisë specifike të një institucioni tjetër publik. Por edhe sikur ky parashikim të mos ishte bërë në këtë pikë, se ky parashikim është bërë për teknikë legjislativ. Për t'iu referuar detyrimeve që burojnë nga legjislacione të tjera, çdo entitet, çdo person fizik apo juridik dhe çdo subjekt i interesuar absolutisht, në bazë të ligjit "Për informimin publik", ka të drejtë të vazhdojë t'i kërkojë informacionet, në mënyrë që ato të vijnë brenda kuadrit ligjor përkatës. Pyetjes se kush e jep gjobën dhe ndaj kujt e jep gjobën Komisioneri, nëse më lejohet përgjigjja, po ju përgjigjem se Komisioneri referohet nga subjekti i cili konstaton se ka një shkelje të ligjit "Për informimin publik". Gjoha do t'i referohet atij entiteti, i cili është në mospërbushje të detyrimit ligjor. Në qoftë se çështja specifike apo shkresa specifike i referohet informimit dhe komunikimit mediatic, patjetër që shkelësi, nëse do të kishte një gjë të tillë, do të ishte agjencia. Nëse çështja i referohet një informimi për një çështje të institucionit publik specifik, siç mund të jetë një ministri apo një agjenci tjetër publike, patjetër shkelësi i bie që të jetë ai entitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zëdhënësi i ministrisë nuk ka lidhje, ka lidhje me entitetin publik përkatës. Dua të kujtoj edhe diçka tjetër. Në kuadër të informimit publikut, në kuadër të rritjes së transparencës dhe efikasitetit të performancës së secilit institucion publik drejt zbatimit të parashikimeve ligjore "Për informimin publik", kemi më shumë se një koordinator, sepse ai ligjor paracakton një koordinator specifik, që është personi përgjegjës për informimin, ose i quajtur ndryshe Koordinatori i Drejtës së Informimit. Ai entitet buron nga një ligj dhe patjetër që ai nuk shkrihet, se parashikohet ose hartohet një VKM dhe, në bazë të hierarkisë së akteve, ai koordinator do të vazhdojë të ekzistojë, sepse është një entitet ose një strukturë specifike, lindur si një detyrim i një akti ligjor superior, siç është ligji "Për të drejtën e informimit".

Nëse ne rritim numrin e personave që i shërbejnë më mirë transparencës dhe efikasiteti të performancës së institucioneve publike, kjo është vetëm një iniciativë që duhet përkrahur, se sa janë entitetet që vihen në konkurrencë me njëra-tjetrën apo bëjnë përplasje të funksioneve të secilit. Të gjitha janë në një funksion të vetëm, që është transparenca, rritja e përfshirjes së individëve në

politikëbërje, në vendimmarrje, por edhe në dhënien e marrjen e mendimit të tyre për sa u përket politikave të caktuara, akteve të caktuara apo zbatimit të politikave dhe të akteve ligjore.

Një pyetje tjetër kishte të bënte me edukimin qytetar. Në fakt, zonja e citoi saktë se agjencia, ndër të tjera, siguron edukimin qytetar për punën e Këshillit të Ministrave dhe sigurimi i edukimit qytetar është punë e çdo funksionari publik, nuk është punë vetëm e një entiteti publik. Edhe deputetët e kanë detyrimin për të siguruar edukimin qytetar për sa u përket funksioneve të tyre si deputetë, por edhe të institucionit ku bëjnë pjesë. Çdo institucion publik patjetër që ka detyrimin për ta bërë një gjë të tillë dhe sa më mirë ta sigurojë atë, qytetari do të ndihet i shërbyer nga ata që paguhen për këtë funksion. Çfarë siguron agjencia në rastin konkret?! Agjencia siguron edukimin qytetar me punën e Këshillit të Ministrave dhe të administratës shtetërore, pasi qytetarët duhet të kenë disa mjete të informimit të të drejtave, disa mjete të informimit të detyrimeve, sidomos t'i kenë të qarta, të thjeshta dhe sa më të sakta.

Programet e edukimit civil ose qytetar nuk janë vetëm programe të institucioneve publike shqiptarë, por ndihmohen në këtë funksion nga shoqëria civile, nga qytetarët aktivistë, pra nga të gjithë ata të cilët e ndiejnë këtë detyrim qytetar, të cilët, ndryshe nga institucioni publik, e ka detyrim për ta kryer. Pra, të tjerët e kryejnë në mënyrë vullnetare, institucionet publike edukimin qytetar e kanë detyrim kushtetues. Kështu që, për teknikë legjislative, nëse mendoni se ka ndonjë gabim në hartimin e kompetencave, jam gati t'u përgjigjem pyetjeve që mund të jenë më shteruese për qëllimin e ligjvënësit në rastin konkret.

Një pyetje tjetër kishte të bënte me donacionet. Ligji për menaxhimin e buxhetit të shtetit parashikon shumë qartë se cilat janë mënyrat se si financohen institucionet publike. Financimi është me para të buxhetit të shtetit, me donacione të ligjshme apo me mjete të tjera të ligjshme. Kjo është një formulë që do ta gjeni kudo dhe i referohet një institucioni publik. Kjo është një formulë që buron nga ligji për menaxhimin e buxhetit të shtetit. Kjo është arsyeja pse, për teknikë legjislative, çdo institucion buxhetor duhet ta ketë patjetër këtë parashikim ligjor. Ka disa mekanizma të tjerë, të cilët kontrollojnë, monitorojnë, që të mos abuzohet dhe disa mekanizma që verifikojnë dhe analizojnë si të quhen ato donacione ose burime të tjera të ligjshme, të cilat ndihmojnë institucionin publik. Zoti Fuga përmendi një prej tyre, grantet janë një nga format, por ju siguroj se, siç besoj e dini si komision përgjegjës, në fushën e lirisë së medias dhe së drejtës së fjalës ekzistojnë seri programesh gjeneroze të partnerëve strategjikë dhe të shoqërisë civile që ndihmojnë këto institucione të mos mbështeten vetëm në buxhetin e shtetit ose taksapaguesit.

Kështu që kjo është arsyeja. Kjo është një formulë për teknikë legislative që gjendet kudo, pra nuk ka një përzgjedhje specifike vetëm për këtë institucion.

Në lidhje me buxhetin duhet të shtoj se buxheti i Agjencisë sot është një dokument publik, gjendet në ligjin e buxhetit të vitit 2022, i miratuar nga ky Kuvend, madje ka kaluar dhe ka marrë edhe miratimin e këtij komisioni. Ky buxhet planifikohet më përpara, në rastin konkret planifikimin e buxhetit të Agjencisë. Duke qenë se Agjencia nuk kishte filluar të funksiononte dhe e kishte të pamundur të bënte përlllogaritje specifike, sipas një parashikimi, që është pika 2 e dispozitave kalimtare të vendimit të krijimit dhe funksionimit të Agjencisë, thuhet se deri në plotësimin e strukturës së agjencisë dhe caktimin e selisë së saj, drejtori i përgjithshëm do të mbështet në detyrat e tij nga nëpunësit e Kryeministrit. Në rastin konkret në shkresën e firmosur nga zëvendëssekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave është bërë planifikimi i buxhetit, i cili i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, ku zërat kryesorë të parashikuar të buxhetit janë: fondi i pagave, fondi i sigurimeve. Unë mund të them se ky ligj i kaluar në këtë komision është dokument publik. Zërat janë: fondi i pagave dhe i llogarive; në zërin 600, fondi i sigurimeve në llogarinë 601, fondi i shpenzimeve operative në llogarinë 602 si edhe shpenzime kapitale në llogarinë 231.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në momentin që e kemi planifikuar ne kemi pasur mundësi të përcaktojmë metodologjinë e planifikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të ndalem edhe tek interesi i deputetes për emrat e personave punonjësve.

Pra, në rastin konkret metodologjia është e rëndësishme. Duke qenë se është institucion i ri, do të kishte nevojë për një seli të cilën u menduar që të ristrukturohej edhe për të ndihmuar dhe asistuar një institucion tjetër publik të fushës, që të dy institucionet të qëndronin në të njëjtën godinë. Kështu që u bë një parashikim në lidhje ristrukturimit e një godine publike funksionale, si dhe u bënë parashikime për blerje dhe pajisje kompjuterike dhe blerje makinash. Të gjitha këto në llogarinë 231, vlerën e ka 90 milionë e 500 mijë, vlerë e cila, siç e përmendi edhe zoti Fuga, për nevoja të ristrukturimit të buxhetit dhe për nevoja të gjendjes së krizës së krijuar është ristrukturuar nga Ministria e Financave.

Sa i përket zërit të fondit të pagave, zë volumin më të madh së bashku me fondin e sigurimeve shoqërore në shumën rreth 80 milionë njëri dhe 12 milionë tjetri.

Sa i përket shpenzimeve operative ato janë 48 milionë. Janë vlera minimale që i referohen pagesës së dritave, ujit dhe të gjitha detyrimeve me karakter publik. Këto janë shifra publike të një ligji të kaluar në këtë komision, të parashikuara dhe të planifikuara nga departamenti, që unë drejtoj, në mënyrë që një institucion publik të fillojë të ecë.

Tani do të ndalem në përgjigjen e pyetjes së zonjës deputete në lidhje me emrat e personave të punësuar. Në fakt, unë do të desha të njihem me qëllimin e kërkesës për identifikimin, sepse është shumë e nevojshme, edhe në kuadër të së drejtës për përdorimin e të dhënave personale duhet të ekzistojë një qëllim i ligjshëm, nuk duhet të jetë vetëm kuriozitet në lidhje me këtë kërkesë. Patjetër nëse ju do ta vendosni një kërkesë të tillë Agjencisë, ajo do të duhet të marrë mendimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nëse këto të dhëna mund të ekspozohen për momentin pa ndonjë qëllim të caktuar.

Dua të sjell në vëmendje të këtij komisioni që identifikimi i emrave të përveçëm unë mendoj se nuk është i rëndësishëm, por është në të drejtën e secilit nga ju ta mendojë ndryshe. Unë mendoj se, përtej emrave të përveçëm ajo që është e rëndësishme është se kjo Agjenci në pak muaj të funksionimit të saj, siç e përmendi zoti Fuga, vetëm nga janari ka filluar të funksionojë, ka tashmë një rregullore të brendshme të organizmit dhe funksionimit të saj, të firmosur sipas parashikimit ligjor nga Kryeministri, ku janë të përcaktuara qartësisht detyrat e çdo funksionari punonjësi të kësaj Agjencie. Unë mendoj se më ME shumë interes për qëllimin publik do të ishin detyrat e funksionarëve se emrat specifik të çdo personi, por kjo mbetet në të drejtën tuaj për të kërkuar njërin apo tjetrin dokument.

Ju pyetët edhe për statusin e punonjësve. Në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet shumë qartë se personat që janë punonjës të kësaj agjencie, marrëdhëniet e punës së tyre rregullohen në bazë të Kodit të Punës. Nuk ka asnjë parashikim, të asnjë prej modeleve, që ne kemi ndjekur, ku këta punonjës të jenë me statusin e nëpunësit civil. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë është një akt ligjor më të njëjtin rëndësi si ligji për statusin e nëpunësit civil, është dokument kuadër qartë parashikon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e punonjësve dhe punëmarrësve të Republikës së Shqipërisë dhe nuk mendoj se është një akt, i cili ka një rëndësi më pak se ligji për nëpunësin civil, që nënkupton se mbrojtja dhe garancia e të drejtave, por edhe identifikimi i detyrimeve, janë në të njëjtin rang në mos më shumë këto të Kodit të Punës.

Petro Koçi –Ju lutem, të respektojme njëri-tjetrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa- A ka mundësi të flas unë?

Petro Koçi –Posi, ka mundësi të mbarosh ti dhe pastaj të vazhdojnë të tjetër. Po ç’është kjo çudi parlamentare!

Ina Zhupa- Zonja më bëri disa pyetje.

Petro Koçi – Mos ta banalizojmë tani.

Ina Zhupa - Ai është niveli yt, nuk ka të bëjë me nivelin tim.

Petro Koçi – Nuk i bën ajo pyetjet këtu. Ne bëjmë pyetje, ata përgjigjen.

Do të bësh pyetje tjetër, por kur të vijë radha.

Ina Zhupa-Unë nuk dua të bëj pyetje, por dua të bëj sqarim për pyetjet që më bëri.

Po, më kërkoi sqarim zonja.

Petro Koçi – Do ta jap fjalën, por prit të mbaroj unë. Jua thashë edhe pak më parë që do të konsumoni pyetjet, morët përgjigjet. Të thashë që do të bëjnë pyetje edhe kolegët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e vendos ti, nuk mund të flasin me dhunë ata.

Tani do të flas unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pavarësisht gërgëreve politike mendoj se në thelb pyetjet ishin të rëndësishme jo vetëm për interesin politik të PD-së apo të zonjës Zhupa, por për publikun. U bë një shërbim për të gjithë.

Unë kam dy pyetje. Së pari, te pika numër 10 e VKM-së, shkronja “m” thuhet se kjo Agjenci siguron edukimin qytetar me punën e Këshillit të Ministrave dhe administratës shtetërore në vartësi të tij. Unë do të thosha se më saktë duhet të ishte “për punën”.

Gjithashtu, unë dua të di se çfarë metodologjie do të përdoret, sepse njerëzit nuk e kanë shumë të qartë veprimtarinë shtetërore, pra kompetencat e një institucioni, siç është Këshilli i Ministrave, Kryeministria ose institucionet në varësi të tyre. Aty në këtë pikë thuhet pak më vonë që organizon edhe vizita. Pra, që do të thotë se vizitat mund të jenë një pjesë e aktivitetit. Çfarë aktivitete të tjera duhet të ketë që publiku të dijë më shumë për punën e Këshillit të Ministrave? Sepse duke ditur se çfarë kompetencash ka, di edhe si të reagojë. Pra të mos i kërkojë një gjë që nuk e ka kompetencë Këshilli i Ministrave por e ka Kuvendi ose Presidenti. Ne e dimë shumë mirë që na vijnë e na thonë, për shembull, se kjo apo ajo gjykatë ka marrë filan vendim të gabuar, por ama nuk jemi ne që vendosim.

Unë e di shumë mirë se çdo agjenci mund të përfitojë buxhet ose donacione nga agjenci ndërkombëtare homologe ose nga Komisioni Europian. Pra, ka shumë programe dhe projekte që nuk financohen vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga donatorë të tjerë.

Zoti Fuga tha më parë se ka bërë një thirrje për të aplikuar në NATO, me mundësinë që agjenci të ndryshme të përfshihen në fushatën që sqaron dezinformimin e organizuar nga Rusia. Dihet se kjo është një fushë ku ka luftë të vërtetësisë, siç është ajo me predha në Ukrainë, është edhe kjo e predhave të keqinformimit. Tani, në aspektin juridik, a ka të drejtë kjo Agjenci të aplikojë në programe të ndryshme që mund të jenë nga BE-ja ose nga NATO-ja, siç ishte ky rast që doli si pa dashje, por që zgjon një pyetje?

Faleminderit!

Endri Fuga- Tani t'i referohemi saktësisht germës “m” ku thuhet: “Siguron edukimin qytetar me punën e Këshillit të Ministrave ose për punën e administratës shtetërore në varësi të tij, si edhe organizon një program periodik të vizitave në godinat e institucioneve publike me itinerar dhe program të aksesueshëm për qytetarët dhe në veçanti për fëmijët, të rinjtë dhe shkollat”.

Kjo pikë ka të bëjë me pikën kryesore, siç e thatë, ju vizitat, pra ne synojmë që jo vetëm godinat e kryeministrisë, por edhe godinat e tjera të jenë të hapura për publikun, thjesht duke pasur mundësinë që këto godina të vizitohen nga njerëzit të cilët të kenë mundësi të takohen me specialistë, pse jo të marrëdhënieve publike, të kenë mundësi të bëjnë pyetje për mënyrën si funksionon institucioni që vizitohet, cilat janë qëllimet kryesore, si këto institucione mund të jenë sa më të prekshme për publikun, cilat janë rastet, në të cilat publiku mund t'i drejtohet këtyre institucioneve, për çfarë shërbimesh, pse jo edhe cilat mund të ishin raste në të cilat qytetarë të ndryshëm, që kërkojnë të zgjidhin një problematikë, të dinë ku të drejtohen.

Nëse flasim për Kryeministrinë, aty hollë i katit të parë është ambient i aksesueshëm për publikun që shpeshherë kthehet në hapësirë ku artistë të ndryshëm shfaqin punët e tyre, zhvillohen debate, evente, jo gjithmonë të lidhura drejtpërdrejtë me Kryeministrinë. Shpeshherë aty vijën organizata dhe shoqata që nuk kanë lidhje me Kryeministrinë. Pra ne duam që një kulturë të tillë hapjeje që sot e kemi në godinën e Kryeministrisë ta çojmë në të gjitha institucionet e tjera.

Gjithashtu, një pikë tjetër është ajo që ka të bëjë me edukimin e fëmijëve dhe të nxënësve në shkollë, ku fare mirë mund të ketë një kalendar vizitash, që nxënës të caktuar të shkollave të ndryshme mund të vijnë të vizitojnë institucionet shtetërore, të informohen për punën e tyre. Por duhet të kemi parasysh një gjë që teksa flasim ka vetëm 3 muaj që ka nisur puna.

Kur është bërë vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e Agjencisë, janë marrë parasysh modele të ndryshme dhe është tentuar të jetë një model sa më gjithëpërfshirës, por, për hir të limitit kohor që nga fillimi punës së Agjencisë, jo secila prej pikave, të cilat gjenden në VKM-në në fjalë, janë vënë në zbatim. Kjo është një pikë për shembull, që ne, si Agjenci, duhet të fokusohemi më shumë për ta vënë sa më parë në zbatim. Dhe ky është një rast për një tërheqje vëmendjeje për të menduar për këtë gjë.

Petro Koçi –Faleminderit!

Unë do të sugjeroja dhe këtë që nxënësit që vijnë për vizitë, të takojnë edhe titullarë në një moment të caktuar, për shembull.

Zonja Kokona.

Edlira Kokona- Në fakt, për ngritjen e kësaj Agjencie kemi marrë disa modele dhe i jemi referuar programeve specifike të organizmave ndërkombëtare, që e kanë edukimin qytetar sidomos në fushën e medias si rol in e tyre primar. Përmend këtu programe specifike të Këshillit të Europës. Unë kam qenë staf i Këshillit të Europës për shumë vjet dhe jam njohur me mënyrën si organizohen këto programe. Janë programe të edukimit qytetar, ku target grupet janë fëmijët, të rinjtë, minoritetet, grupe vulnerabil, të cilët nuk ndjekin dot konferencën për shtyp të ministres ose Kryeministrit, për shembull, sepse jo të gjithë janë në gjendje ta perceptojnë apo kuptojnë, është detyrë e programeve të edukimit qytetar të mund të targetojnë të arrijnë mesazhi specifik edhe te këto grupe personash. Metodologjia e realizimit të edukimit i ka modelet e qarta, unë ju përmenda Italinë dhe do të vazhdoj të përmend Italinë, e cila në kompetencat e njësish që merret me informimin dhe medien në Presidencë dhe Këshillin e Ministrave ka qëllimin për të informuar grupe të ndryshme të minorancës, mbrojt interesat e grupeve.

Petro Koçi – Dakord., por a ka të drejtë Agjencia ligjërisht që të aplikojë, apo jo?

Elira Kokona – Po i përgjigjem pyetjes suaj: agjencia, si çdo institucion publik, ka të drejtë të aplikojë, duke ndjekur disa rregulla dhe autorizime specifike, siç është rasti konkret, duke marrë miratimin nga Këshilli i Ministrave.

Petro Koçi – Faleminderit!

Zoti Ajazi, fjala për ju.

Besion Ajazi – Faleminderit, zoti Koçi!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar,

Përpara se të bëj një pyetje, sepse dua t'i qëndroj asaj që drejtuesi i seancës na kërkoi me mirëkuptim, që të rrimë larg komenteve politike, dhe si ish-gazetar prej 9 vjetësh, në pozicionin e gazetarit të terrenit në disa televizione prestigjioze, them se e kam kuptuar shumë qartë që nga dita e parë që u hodh si ide dhe më pas vijoi me procedurat zyrtare për krijimin e Agjencisë për Medie dhe Informim, funksionin e saj. Por, ndihem i keqardhur që ka marrë vëmendje kaq të madhe të fryrë artificilisht, sepse ka shumë gjëra të tjera me rëndësi, për t'u kushtuar vëmendjen e duhur sesa krijimit të kësaj Agjencie, e cila, në fund të fundit, ashtu siç tha edhe drejtuesi i saj, do të mirorganizojë punën dhe funksionet e deritanishme, pra atë punë që është bërë deri më tani.

Unë kam një pyetje për zotin Fuga: si ka funksionuar deri më tani i gjithë ky proces, që sot është pjesë e organizimit apo funksionimit nën drejtimin e Agjencisë për Medie dhe Informim? Çfarë ka ndryshuar dhe çfarë është rregulluar me ngritjen e kësaj agjencie në këtë proces?

Faleminderit!

Endri Fuga – Faleminderit për pyetjen!

Arsyeja përse kjo agjenci u ngrit është që t'u jepte një organizim më të mirë këtyre strukturave. Nëse do të ktheheshim pas në kohë, jo të gjitha ministrinë kanë pasur struktura të veçanta, që merreshin me marrëdhëniet publike apo me medien.

Ministrinë më të mëdha, e kam fjalën për Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes, kanë pasur struktura të dedikuara, ndërkohë që pjesa tjetër e ministrive dhe institucioneve kanë qenë më shumë në nivel këshilltari. Duhet pasur parasysh se, nga njëra anë, numrat kanë ngelur të njëjtë apo kanë ardhur në zvogëlim, nga ana tjetër, volumi i punës ka ardhur në rritje. Pra, nëse ne krahasojmë situatën që është sot me 10 apo 15 vjet më përpara, numri i televizioneve është më i madh, rrjetet sociale nuk kanë ekzistuar, portalet kanë qenë në rastin, më të mirë, faqe *uebi* të televizioneve të ndryshme dhe jo agjenci e medie më vete. Pra, volumi i punës është rritur, prandaj ka nevojë që të ketë struktura, si në të gjithë botën, që t'i përgjigjen këtij volumi të shtuar të punës.

Unë dua që të ndalem shkurtimisht në disa gjëra, të cilat mendoj se janë arritje pozitive në këta 3 muajt e fundit, sepse kemi tendencën të flasim për probleme, që potencialisht mund të lindin, por ndërkohë nuk duhet të anashkalojmë disa gjëra që kanë ndodhur. Për shembull, me ngritjen e agjencisë çdo të mërkurë, pas mbledhjes së qeverisë, ministrat propozues të akteve të ndryshme, që kalojnë në mbledhjen e qeverisë, dalin përpara gazetarëve, prezantojnë aktet dhe marrin pyetje nga gazetarët për ato çështje apo për çështje të tjera. Kjo në fund të ditës mendoj se është një vlerë

e shtuar, është një shkallë më e lartë transparence dhe një mundësi më e madhe që gazetarët të komunikojnë me vendimmarrësit, t'i pyesin ata për vendimet që janë marrë apo për çështje të tjera, të cilat janë në interes të publikut apo të gazetarëve. Kjo është një gjë, që ka nisur të funksionojë rishtazi.

Kemi bërë një rikonceptim të faqes *online* të Këshillit të Ministrave, ku informacioni serviret më i thjeshtuar dhe më i lehtë për t'u gjetur, gjë që e bën më të lehtë e më të kollajshme punën e gazetarëve dhe të publikut në përgjithësi. Për këtë gjë unë mund të lexoj edhe shifra, por ne shohim një rritje të numrit të personave, të cilët informohen apo vizitojnë faqen.

Gjithashtu, faqja e Agjencisë shërben si agregator i të gjithë lajmeve, nismave dhe vendimeve të të gjithë ministrive. Nëse më përpara një gazetar apo një qytetar duhet të mendonte se cila është ministria përgjegjëse për një akt, cila është faqja e ministrisë përgjegjëse dhe të futet në atë faqe dhe t'i kërkonte të ndara një më një secilën nga institucionet apo ministritë, tani është më e lehtë. Pra është një hap përpara për transparencën. Gjëra të tilla unë mund të them disa, të cilat janë të bazuara në fakte dhe në shifra.

Agjencia ka 3 muaj që ka filluar të funksionojë, ku kemi pasur disa gjëra pozitive dhe në këndvështrimin tim nuk mendoj se kemi pasur ndonjë problematikë, që lidhet me punën e Agjencisë.

Petro Koçi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Petro Koçi – Pyetja dhe komenti i fundit për sot.

Ina Zhupa – Mos më provokoni, më lini mua ta them se është e fundit, sepse ndryshe më detyroni të bëj pyetje përsëri.

Faleminderit për përgjigjet që dhatë, por kam nevojë për disa sqarime të tjera nga zoti Fuga, por dhe nga zonja Kokona. Meqenëse ra fjala, nuk keni bërë prezantim të zonjës, se zoti Fuga u shqetësua që kisha celularin, por më shkruan gazetarët për pozicionin dhe emërimin zonjës që po fliste. Ky duhet të ishte një prezantim që gazetarët ta dinin...

Petro Koçi – Prezantimi u bë që në fillim.

Ina Zhupa – Po, por kur foli zonja, gazetarët më shkruanin se si quhet, se u shqetësuan për këtë pjesë.

Zoti Fuga, ju thatë një të drejtë, propaganda ka ekzistuar, do të ekzistojë edhe pavarësisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thatë që ka ekzistuar më përpara ose të paktën ju na keni akuzuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, por ndryshimi i madh është që ju tani e keni institucionalizuar propagandën në një agjenci, që paguhet me taksat tona.

Së dyti, ju flisni për një model gjerman, a e dini sa gjëra kemi marrë ne nga Gjermania, Italia, nga Bashkimi Europian, sepse na duhet t'i përafrojmë me *acquice communitare* dhe në fund i kemi bërë allashqiptarçe? Pra, modeli gjerman nuk e përjashton qasjen allashqiptarçe edhe për agjencinë, mënyrën se si funksionon ajo dhe qëllimet që ka ajo, sepse, po ta keni parë, ERTV-ja zëvendësohet me këtë agjenci.

Së treti, për të mos i marrë kohë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk thashë ashtu.

Së treti, nga ajo që tha zonja Kokona, 2 miliardë e 68 milionë lekë, e ritheksoj 2 miliardë e 68 milionë lekë, është buxheti për Agjencinë e Medies dhe të Informimit, pra për ministrinë e propagandës.

Kur ne kërkojmë punonjësit, zonja drejtore, zëvendëssekretare e Përgjithshme e Këshillit të Ministrave, nuk kërkojmë një sekret shtetëror, por këta punonjës të shtetit. Unë do t'jua sjell edhe me shkresë dhe të argumentuar. Nëse qeveria juaj do të ishte kaq sensitive për të dhënat personale, nuk do të ishte sistemi i patronazhistëve dhe të dhënat personale të njerëzve të ishin mall publik. Ne nuk kërkojnë as ID-të e këtyre njerëzve, por vetëm emër dhe mbiemër, për ta ditur në fund të ditës, edhe pse zoti Fuga e shmangu përgjigjen e *Facebooku*-t dhe mirë bëri se është në tagrin e tij edhe për ta shmangur, ta dimë se kush po na komenton, sepse po paguhet nga taksat tona për të sharë apo për të lançuar opozitën. Ne nuk po kërkojmë ndonjë gjë të madhe. Megjithatë, do t'jua sjell shkresën institucionalisht, meqenëse ata paguhet me taksat tona, të dimë se kë paguajmë, sepse janë punonjës shteti, nuk është një agjenci kulte, që duhet t'i ketë emrat sekretë, sepse cenohen të dhënat personale.

Nga ana tjetër, ju thatë, e mbështesni atë që thashë edhe unë, që zëdhënësit, në rast të një qeverie koalicioni, siç ju pyeta, do të jenë në kontroll dhe në monopolizim të një linje të

Kryeministrit se çfarë duhet të thonë dhe se si duhet ta thonë, sepse ndryshe ndikohen nga vetë ministrat që kanë për detyrë që t'i emërojnë. Tani zëdhënësi

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonjë, nuk ka limit koha, se jemi bashkë në grupin “Miqtë e fëmijëve” dhe kam edhe një pyetje tjetër për këtë gjë. Koha, fatmirësisht, nuk ka limit. Mund të merrni një vendim maxhorance dhe të vini ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani ta mbaroj unë, sepse ju ma zgjasni më shumë.

Në fakt, ju vërtetuat atë që thashë, se kjo gjë bën monopolizim dhe kontrollin që asnjë ministër të mos dalë nga linja e Edi Ramës. Këta nuk ankohen, sepse e marrin vesh kur i emëron dhe i çëmëron *live* në emision dhe nuk kanë këllqe t'i ankohen Ramës dhe t'i thonë: “Prit, se jam unë ministri, vendos unë se kur do të dal, si do të dal dhe cila është linja ime”. Ju e pranuat këtë gjë dhe bëtë shumë mirë. Kur nuk ankohen ata, unë po ankoem në emër të qytetarëve për të marrë një informacion sa më të decentralizuar.

Së katërti, këtë e kam pyetje për zotin Fuga, të kërkoj ndjesë që nuk e bëra përpara, sepse nga shënimet e shumta më ka kaluar. Para pak ditësh, zoti Fuga, ishte kongresi i Partisë Socialiste; në këtë kongres kishte panele të caktuara me ministret, të cilat shfaqnin propagandën e tyre e të tjera. Meqenëse agjencia është përgjegjëse për aktivitetin e ministrave në publik, a i ka organizuar këto panele Agjencia për Mediet dhe Informimin, meqenëse bëhet fjalë për punën e qeverisë, për performancën e ministrave, si ministrat flasin atje, për gjërat që do të bënin atje? Kaq dua të di, a e ka organizuar? Ndërsa për pjesën e parave, le të bëjë transparencë Partia Socialiste.

Për sa i përket çështjes që e ngrit zoti Petro, e thatë edhe ju, për edukimin qytetar, ju lutem, këtu në komision, në medie bëni çfarë të doni, mos na tregoni përralla të bukura me fëmijë të lumtur, që vijnë dhe shikojnë xhaxhi Edin që punon, që loz me topin e basketbollit, që pikturon e të tjera. Edukimi qytetar, zonjë, është lëndë në kurrikulat e shkollës, lënda “Qytetari”.

Vizitat në institucione, zonjë, kanë qenë dhe janë pjesë e aktiviteteve që bën Ministria e Arsimit. Unë dhe zonja Dasantila jemi nënkryetare të grupit “Miqtë e Fëmijëve” dhe disa nga gjërat që bëjmë, janë vizitat që fëmijët do të bëjnë në Kuvend, në seancën plenare, kanë qeverinë e nxënësve e të tjera, pra nuk e siguron agjencia ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, të them, zonjë, që mos bëni sikur këtu nuk ka ekzistuar asgjë dhe ju krijuat një Agjenci që do të siguroni edukimin qytetar, sepse nuk e besoj. Mund të ketë njerëz që nuk e dinë dhe mund t'i besojnë, por po flas për njerëz që e dinë se çfarë ka ndodhur dhe çfarë ndodh në këtë vend. Pra, mundësisht atë teknikën legislative që keni vendosur, ndoshta edhe për të fshehur këta 2 miliardë e 68 milionë lekë që do të harxhoni, duke thënë se po sigurojmë edukim qytetar, ndryshojeni se bëheni qesharak, nuk është se tregoni ndonjë gjë.

E fundit, besoj se do të jetë e fundit, nëse nuk do të ketë komente që mund të më sjellin ndonjë gjë në mëndje, zoti Fuga kam një kërkesë miqësore. Meqenëse i ndjek me vëmendje fjalimet e ministrave e të tjera, për shkak të punës, a ka mundësi t'jua ndryshosh ato *talking points*, sepse i kanë të njëjtat dhe nuk i kanë ndryshuar. Unë të jap me garanci se mund të dal e të bëj një fjalim me të gjitha pikat që keni bërë ju, jo “lufta”, “e papritura”, “nuk e vendosim ne çmimin”, “tërmeti”, “pandemia” dhe “qeveria më e mirë bashkëqeverisja qytetare”. Pra, ndryshojeni një herë ose lëreni që të flasin vetë dhe ne t'i shikojmë se çfarë dinë të thonë pa ju vendosur pikat e diskutimit. Këto kisha.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Zhupa!

Përrjashto pyetjen e fundit, sepse nuk besoj se shtrëngohen ministrat se çfarë të thonë, ata thonë çfarë të duan.

Endri Fuga – Unë nuk do t'i përgjigjem pyetjes së fundit, sepse jam i sigurt se nëse do t'i përgjigjem atëherë do të ketë pyetje të tjera.

Zonja Zhupa, meqenëse thatë se këto ishin pyetjet e fundit, unë dua t'i lëmë me përgjigjet e fundit. Për çështjet që kanë interesin tuaj personal, i cili buron nga puna që ju bëni, mund t'i konsumojmë pas seancës dhe mund t'i diskutojmë me shumë kënaqësi.

Më vjen keq vetëm për një gjë, fatkeqësisht, nuk është hera e parë që ndodh, ndoshta ju nuk keni pasur rast të më ndiqni më përpara, por unë ju kam ndjekur juve më përpara. Ka një zakon, që gjithmonë i vihen tjetrit në gojë fjalë që nuk i ka thënë. Unë nuk paragjykoj asnjë mendim që ju mund të keni, por atë paraqiteni si mendimin tuaj, mos e paraqisni si mendimin tim. Pra, nëse ju thatë që propaganda ka ekzistuar, ky mund të jetë mendimi juaj dhe nuk e paragjykoj, por unë nuk e thashë këtë fjalë. Unë thashë: akuzat për propagandë kanë ekzistuar, nuk thashë propaganda ka ekzistuar, prandaj të jemi të qartë. Kur e thoni ju, e thoni ju se është mendimi juaj, unë nuk jam

këtu për të bërë debat me ju, por për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja. Thjeshtë dua të jem i qartë, që të mos më vendosni në gojë fjalë që unë nuk i kam thënë.

Së dyti, folët për modelin gjerman, duke thënë se kemi marrë ligje nga vende të ndryshme të botës, ndoshta unë ju dukem naiv, por ndoshta jam thjesht idealist. Unë dua që Agjencia për Medie dhe Informim Shqiptar të kthehet në një model sa më të ngjashëm me Agjencinë Fedreale për Shtypin dhe Informimin në Gjermani. Pastaj se sa të aftë do të jemi për ta përmbushur këtë sfidë apo jo është një pyetje tjetër, por puna ka filluar dhe shpresoj të jemi të aftë për ta përmbushur. Pra, objektivi është që agjencinë ta ngremë lart dhe jo të kënaqemi me gjëra të vogla, që mund të kenë ndodhur më përpara.

Një përgjigje lidhet përsëri me ndjekjen e herëve të tjera, që ju keni qenë në komisione të ngjashme. Unë ju sugjeroj se kur bëni pyetje, duhet të merrni parasysh edhe përgjigjet, në kuptimin që ju përsërisni sërish 2,68 miliardë lekë, 2,68 miliardë lekë. Kjo fjali do të ishte shumë më e saktë nëse do të bëhej përpara se unë dhe zonja Kokona të kishim folur dhe shpjeguar. Por në momentin që ne shpjegojmë dhe ju themi që shuma në fjalë është e parashikuar përpara funksionimit të agjencisë dhe se zërat kryesorë të kësaj shume që kanë të bëjnë me qiratë, rikonstruksionet apo blerjet e mjeteve, makinave që do të transportojnë stafet, janë zëra, të cilat nuk do të jenë më, për shkak se janë gjetur zgjidhje alternative apo për shkak të situatave që janë duke ndodhur, ju këto gjëra duhet t'i merrni parasysh. Nëse unë ju them se brena kësaj shume 2/3-t apo më shumë e zërit që parashikon pagat dhe sigurimet shoqërore, janë zëra që ekzistojnë sot që flasim, jo tek agjencia, por në një institucion tjetër. Pra, nuk janë para të reja, që nuk harxhoheshin deri dje dhe po harxhohen sot, jo, janë para që harxhoheshin deri dje, thjesht kanë lëvizur nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe kanë ardhur tek Agjencia. Prandaj, unë e kuptoj pozicionin tuaj dhe nuk dua të debatoj në asnjë moment me ju, thjesht, në shërbim të gjithë atyre që na ndjekin, të jemi të qartë që kur flasim për shifra, të kemi parasysh edhe shtjellimin që kemi bërë për shifrat në fjalë.

Ju thoni se doni të dini emrat e punonjësve për të parë nëse këta futen në *Facebook* dhe bëjnë *like* apo koment. Siç jua tha zonja Kokona, ju mund të kërkoni emrat dhe për aq kohë sa komisioneri përkatës mendon se emrat mund t'ju vihen në dispozicion, sigurisht ne do të respektojmë vendimin dhe do t'jua vëmë në dispozicion.

Unë ju siguroj se njerëzit që punojnë në agjenci janë mjaftueshëm të zënë me punë dhe nuk kanë kohë të bëjnë *like* apo komente në faqet tuaja apo faqet e të tjerëve, por, edhe sikur ta bënin në kohën e tyre të lirë, unë nuk besoj se njerëzit nuk lejohen të komentojnë në *Facebook* apo të

bëjnë *like* në *Instagram*. Gjithsesi, nëse ju i doni emrat dhe nëse komisioneri i çmon të arsyeshme këtë gjë për këtë arsye, sepse mund të keni edhe arsye të tjera, nuk do të jemi në pengesa për këtë gjë.

Ju folët në rastin e qeverive të koalicionit. Duke ju kërkuar ndjesë personave të tjerë për tejzgjatje, doja të ndaja shkurtimisht që gjatë vizitës në Gjermani nuk ishte i pranishëm drejtori i ri i agjencisë gjermane, por nëndrejtoresha dhe, përpara se të fillonte konferenca për shtyp teksa Kryeministri dhe Kancelari po zhvillonin takimin kokë më kokë, pata disa minuta dhe po bisedoja me zëvendësnëndrejtoreshën e agjencisë gjermane, të cilën e pyeta: çfarë ke bërë me parë dhe si erdhe këtu? Më tha: “Ne kemi një veçori, se drejtori është nga social-demokratët, meqenëse Kancelari është nga social-demokratët dhe kemi dy nëndrejtorë, njëri jam unë, që jam propozuar nga të gjelbërit, partia tjetër e koalicionit, dhe tjetri është propozuar nga liberalët, që janë anëtarët e tjerë të koalicionit”.

Këtë e them për një arsye shumë të thjeshtë: pavarësisht se çfarë diskutimi mund të bëjmë me njëri-tjetrin, fakti është që në çdo qeveri në çdo vend të botës, disa pozicione janë pozicione politike kur vjen puna të zëvendësi, të këshilltarët, të drejtorët e kabinetëve. Këta janë njerëz politikë dhe janë të tillë gjithandëj dhe ne mund të bëjmë lloj-lloj shpikjesh, prandaj jua solla këtë si shembull, se nuk jemi ne i vetmi vend.

Pyetja e parafundit që ju kishit, por pyetja e fundit së cilës do t’i përgjigjem, ka të bëjë me kongresin. Përgjigjja është e thjeshtë. Nuk kanë qenë stafet e ministrive ato që kanë organizuar KONGRESIN e PS-së, as panelet paraprake. Ju kujtoj se Kongresi i PS-së është zhvilluar ditën e shtunë, që është një ditë pushimi dhe unë kam qenë i pranishëm në sallën ku janë zhvilluar panelet dhe kongresi, por jo në cilësinë e drejtorit të agjencisë dhe, sigurisht, nuk kam pasur stafe të agjencisë të angazhuara për kongresin. Faleminderit!

Petro Koçi – Zonja Buxheli fjala për ju. Sa më shkurt ju lutem!

Lindita Buxheli – Unë kisha shumë shkurt disa pyetje, të ardhura edhe në celular, megjithëse një pjesë e mirë u ezauruan edhe nga përgjigjet e deritanishme.

A ka një fushatë informuese për risitë e agjencisë, sepse mund të jenë jo shumë të informuar, domethënë veç shpejtësisë, saktësisë, pra një element tjetër kyç, që sjell agjencia?

Petro Koçi – Zoti Fuga.

Endri Fuga – Ndjesë se nuk e kuptova pyetjen: a duhet bërë një fushatë informuese për vetë agjencinë? Unë besoj se kjo e sotmja është një rast i mirë për të sqaruar publikun, falë zonjës

Zhupa. Ne nuk besojmë se duhet të shpenzojmë para nga buxheti i shtetit dhe nga taksapaguesit për të bërë një fushatë për agjencinë, por ndoshta mund të bëjmë një fushatë pa kosto në rrjetet sociale, ku të gjitha pyetjet që bëri zonja Zhupa mund të ndërtohen në formë pyetje-përgjigjesh për të sqaruar më shumë publikun. Patjetër që është një mendim i mirë, të cilin do ta marrim parasysh. Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Fuga!

Faleminderit, zonja Kokona!

Ne jemi komision parlamentar dhe mbikëqyrim të gjitha institucionet shtetërore që lidhen me fushën e këtij komisioni dhe, natyrisht, kërkojmë prej jush zbatimin me rigorozitet të gjithë formatit ligjor, nga i cili jeni krijuar dhe besoj se në vazhdimësi do të vijojmë të monitorojmë këtë veprimtari.

Gjithsesi, në emër të komisionit do të kërkoj dy gjëra: të realizohet transparenca dhe jo zbulurimi i gjërave, që mund të kthehen në një interpretim propagande, siç është dëshira e opozitës ta identifikojë një proces të tillë; e dyta, kërkojmë që detyra e agjencisë që të informojë qeverinë për ç’ka vlerësojnë qytetarët, pra ajo që ju testoni mes sondazheve, të jetë në nivelin maksimal, sepse një qeveri që reflekton është një qeveri e mirë.

Së fundi, dua të falënderoj të gjithë kolegët që bënë pyetje, sidomos zonjën Zhupa!

Dua t’ju informoj që përgjigjet e të dyja universiteteve, për të cilat dërguam pyetje, për shkak të pretendimeve të studentëve për mospagesat e bursave, kanë ardhur, edhe nga Universiteti i Mjekësisë, edhe Politekniku, i keni në *e-mail*.

Faleminderit!

Do t’ju njoftojmë për mbledhjen tjetër.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA